

HEJZA



Rita PETRO

"NUK KAM KRIJUAR KURRË SE DUHET, POR SE DUA"

ALARM I RRREMË

Në prill të vitit 2007, kryeministrit të atëhershëm, Nikolla Gruevskit, iu drejtua një letër interne, e nënshkruar nga nëpunësit maqedonas të Ministrisë së Kulturës. Veç tjerash, kërkohet që urgjentisht të stopohet nisma dhe këmbëngulja e z. Arbën Xhaferit për themelimin e "njëfarë Instituti për trashëgimi kulturore e shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë "Pjeter Bogdani"! Nënshkruesit e kësaj letre po tmerroheshin nga politikat që kulturën shqiptare do ta nivelizonin me kulturën maqedonase. "Të hiqet dorë prej të gjitha ministrive, të gjitha t'ua jepte shqiptarëve, vetëmse maqedonasit ta merrnin në duar ministrinë e kulturës", thuhej në atë letër



Nga Avni HALIMI

Departamenti i kulturës, arsimit, shkencës e shëndetësisë janë departamente që i prekin interesat kombëtare, ndërsa departamentet e tjera i përkasin interesave shtetërore. Kjo bëhet më e theksuar dhe shumë më e realët sidomos në ato shtete që janë multietnike. Mandatori i shumicës etno-politike për asnjë çmim nuk do të hynte në bisedime për formim të qeverisë nëse minoranca politike do të këmbëngulte për të marrë një nga sektorët e lartpërmendur, sidomos ministrinë e kulturës. Ose, mund të jepen këto dikastere me kusht që ministrat t'i përgjigjeshin ekskluzivisht kryeministrit dhe jo edhe njëkohësisht liderit të partisë.

Lotët e krokodilit

Më vitin 2006, kur vendin po e qeveriste koalicioni VMRO-PDSH, shqiptarët, si asnjëherë tjetër, kishin ministri më të rëndësishme për një popull. Për herë të parë në historinë e Maqedonisë së Veriut shqiptarët po e drejtonin ministrinë e

pulenin e ish-kryeministrit, Nikolla Gruevskit, që si urith po përpiqej t'i mihë deri në rrënim sukseset shqiptare në kulturë. Elizabeta Kançevska, sekretare shtetërore e atëhershme, kishte inicuar një letër të hapur drejtuar kryeministrit Gruevski. Letra ishte nënshkruar prej të gjithë nëpunësve maqedonas. Letra ra në duart e ministrit shqiptar (Arifikmet Xhemali) pikërisht nga një militante e opozitës maqedonase, e cila nuk kishte pranuar ta nënshkruajë letrën. Në katër faqe e gjysmë ishte derdhur një vajtim qyqesh e një urrejtje. Po vajtohej me shumë mllef, pezëm e urrejtje strategjia kombëtare e Arbën Xhaferit që po e synonte institucionalizimin e plotë të jetës kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë. Po lutej Gruevski që sa më shpejt dhe në mënyrë urgjente të prishte koalicionin ose ta merrte këtë ministri, sepse, "nismat për themelim të institucioneve kulturore shqiptare po e rrezikonte identitetin kulturor e nacional të popullit të shenjtë maqedonas"! Kërkohej që urgjentisht të stopohet nisma e z. Xhaferi për themelimin e "njëfarë Instituti për trashëgimi kulturore e shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë "Pjeter Bogdani"! Nënshkruesit e kësaj letre po derdhnin rrëke lotësh nga dhembja se si kultura shqiptare po nivelizohej me kulturën maqedonase. Vajtuesit po frikësoheshin se shumë shpejt shqiptarët do t'ua merrnin antikën maqedonasve. Ndaj dhe kryeministri lutej që, për hir të interesit kombëtar maqedonas të hiqte dorë prej të gjitha ministrive, të gjitha t'ua jepte shqiptarëve, vetëm ta merrte në dorë ministrinë e kulturës.

Kush i heshti gazetarët shqiptar

Një vit më vonë kësaj letre të hapur drejtuar kryeministrit, ndodhi marrja e ministrisë së kulturës nga maqedonasit. Një vit më vonë në krye të këtij dikasteri u emërua iniciatorja e kësaj letre, personi më flegmatik përse i përket jetës kulturore, personi i përjetuar për nëpërkëmbjen e jetës kulturore shqiptare, Elizabeta Kançevska, e cila, karrierën e vet në këtë ministri e nisi si sekretarëshë e thjeshtë dhe më vonë, duke derdhur pa hesap pare nëpër mediat e vendit, prezantohet si ministreshë nga më të suksesshmet e kombit maqedonas. Ky sukses matet me forcën për të shkelur sa më shumë e sa më gjatë mbi jetën kulturore shqiptare. Është për t'u habitur se si, sapo ky dikaster iu mor shqiptarëve u heshtën të gjithë ata gazetarë shqiptarë, të gjithë ata intelektualë shqiptarë (nja 2-3 më të zëshmit) të cilët derdhnin gurë e dru mbi këtë ministri derisa drejtohej me sukses nga shqiptarët. Këta gazetarë ose atëherë ishin paguar nga shërbimet maqedonase që të bëjnë zhurmë, ose sot janë paguar prej po të njëjtëve shërbime që të heshtin përballë nëpërkëmbjes flagrante të kulturës shqiptare. A ka më turp dhe më ofendues se sa një aktivitet kulturor shqiptar të mohohet nga zëvendësministri serb! Komisioni parlamentar për kulturë kishte kaluar kërkesën që të festohej 100 vjetori i shkollës së parë shqipe "Josif Bageri"! Natyrisht, ky komi-

sion parlamentar obligon ministrinë përkatëse për ta ndihmuar materialisht këtë përvjetor. Ministresha e refuzon, ndërsa, për të qenë refuzimi edhe më ofendues kërkoi që këtë vendim refuzues ta nënshkruajë zëvendësministri që vinte nga radhët e pakicës serbe në Maqedoni.

Projektet që shtonin buxhetin e partisë

Ekzistonte edhe një arsye tjetër, madje „rationale“ për njeriun që nuk kishte lidhje me kulturë, siç ishte ish-kryeministri Gruevski, për marrjen e ministrisë së kulturës nga duart e shqiptarëve. Madje, çuditërisht, ndonëse posti sekretar shtetëror i takonte shqiptarit, përfundoi një mandat të plotë që kjo ministri ishte e vetmja që nuk kishte emëruar person në këtë post. Duhej të shtyhet edhe pak kjo punë, derisa të përfundonin të gjitha projektet "kulturore" të Qeverisë të cilat duhet t'i realizojë Ministria e Kulturës. Në atë kohë, ndër projektet „e fundit“ ishte projekti "100 nobelistët" që duhet të përkthehen vetë në gjuhën maqedonase. Behët fjalë për miliona libra! Sikur të fitohej vetëm nga një euro në libër! Pastaj, projekti paralel përkthimi vetëm në maqedonisht i „Yjet Botëror“ (shkrimtarët botëror), që nga antika e deri te më bashkëkohori, diku nja 500 autorë botërorë! Pastaj, përkthimi në anglisht, në frëngjisht, në rusisht, në arabisht madje edhe në kinezçe i projektit "Letërsia maqedonase", mbi 100 autorë maqedonas. Përkthimi i mijëra titujve universitarë që përdoren si literaturë bazë nëpër universitetet më të mëdha botërore. Gjithsesi, duhet nënvizuar edhe buxhetin për gjurmime arkeologjike, për ndërtimin e përmendoreve dhe të skulpturave. Po investimet kapitale? Ishin shumë! Të gjitha me tender! Njerëzit e Gruevskit mendojnë se tenderat janë të shpikur për të fituar para ekskluzivisht partia që udhëheq qeverinë! Ekziston një klauzolë e cila u mundëson në mënyrë interne që firmat fituese të tenderit më vonë të kërkojnë plus deri në 20 për qind të kostos së përgjithshme të projektit. Natyrisht, këto lekë do të shkojnë tek ai i cili bëhet "sebeq" për t'u fituar tenderi.

Kryeministrit i interesojnë vetëm lekët, përfitimet, fitimet dhe mirëqenia ekonomike e partisë, ndërsa ministreshës së kulturës i intereson ta zbatojë kërkesën e kryeministrit. Në planin individual kjo ministreshë, këmbëngulte ta demonstrojë forcën në drejtim të realizimit të "projekteve kulturore"! Një nga këto "projekte" ishte edhe nëpërkëmbja transparente, devaluimi sy më sy dhe ngulfatja deri në "vdekje" të kulturës shqiptare në Maqedoninë e veriut. Dikush duhej ta zbrapste këtë orientim obsesiv e psikopatik të ministreshës. Maqedonasit ia dolën ndonëse nuk u ndihmuan nga asnjë shqiptar, qoftë edhe me vetëm një zë kritik kundër ministreshës së xhindosur! Ajo "u tret" ndërsa për fatin e saj të zi vazhduan të funksionojnë të gjitha institucionet nacionale shqiptare që i themeloi i madhi, z. Arbën Xhaferi, gjatë tetëmbëdhjetë muajve në pushtet.

GJASHTËQIND VJET NDJENJË E DHIMBJES

Kënga "Moj e bukura More" edhe ndjehet, edhe këndohet, edhe interpretohet, edhe vlerësohet, edhe rimëkëmbet, edhe frymëzohet për të dhënë një mesazh të qartë

Sami PIRAJ

Nga data 24 deri më 26 mars 2023, në Komunën e Vitisë, u mbajt Festivali "Flakadani i Karadakut", i cili sivjet shënojë edicionin e 21 me radhë. Ne nuk do të ndalemi në prezantimin e grupeve, e të shoqërive që erdhën në skenë nga të gjitha trojet shqiptare, sepse nuk është temë e cila do të trajtohet me këtë rast. Na bëri përshtypje që për herë të parë në këtë manifestim u prezantua një grup muzikor i Arbëresheve të Italisë, të cilët u nderuan me çmimin Special të Festivalit. Arritja e tyre në këtë manifestim tradicional në Viti, prurjet e tyre në këtë skenë me pika muzikore të veçanta tipike arbëreshe, kostumet tradicionale, pastaj përcjellja e pikave muzikore me zëra të bukur, gjuha e shtjellimit të këtyre këngëve e përcjellë brez pas brezi, shekuj me radhë, të bënë të ndjehesh i lumtur dhe njëkohësisht i nderuar për tërë këtë pasuri të trashëguar e cila u prezantua në skenë e brumosur me ndjenjën e stërholluar muzikore e poetike. Shi nga kjo, u bëmë kureshtarë të gjurmohet pak më thellë në rrënjët melodike të këtij nënqielli që me aq dashuri edhe sot ndjehen dhe u prezantohen publikut gjithandej. Shtrohet pyetja se çka e bënë të nderohet dhe vlerësohet gjithë kjo pasuri artistike?

Timbri dhe shpirti i një populli i migruar

Të futesh në këngën dhe melosin arbëresh, mbetesh i habitur, por njëkohësisht i ngazëllyer dhe i motivuar të gjurmohet rrënjët muzikore të këtij nën qielli. Çfarë dua të them më këtë?! Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se shumë këngë të cilat janë prurje aq të pranishme në opusin e këngës shqipe, kanë origjinë arbëreshe. Edhe pse ato modifikohen, orkestrohen dhe interpretohen në forma të ndryshme të kultivimit zhanror, esenciale mbetet timbri dhe shpirti i një populli të migruar që aq shumë i dha këngës shqiptare. Do të thosha pa asnjë mëdyshje që as letërsia shqiptare nuk do të kishte at peshë sikur mos të ishte shpirti i De Radës dhe arbëreshëve të tjerë.

Tradita nuk është statike dhe ajo dinamizohet në etapa të ndryshme. Merr formë dhe përmbajtje nga më të ndryshmet, varësisht nga qasja dhe mënyra e shtjellimit, gjithnjë duke pasur parasysh profesionalizmin në formë dhe përmbajtje. Aq sa kisha informacione nga koncertet dhe paraqitjet skenike të grupeve muzikore arbëreshe, aq kisha edhe ndjenjën e bukur të muzikalitetit të këtij populli që jeton në katundet në jug të Italisë. Aq më bënte përshtypje Himni i tyre i cili përcjellë tash e 600 vjet rresht, atë ndjenjën e dhembjes së ndarjes dhe



mallëngjimit. Dhe 600 vjet kjo ndjenjë kurrë nuk u venit, përkundrazi është e prekshme dhe e përjetësuar si një frymëzim për gjeneratat e reja. Kënga "Moj e bukura More" edhe ndjehet, edhe këndohet, edhe interpretohet, edhe vlerësohet, edhe rimëkëmbet, edhe frymëzohet për të dhënë një mesazh të qartë. Ky mesazh është shpalosje e identitetit kombëtar përmes vargjeve: "Si të lash e më s'të pash, atje e kam zonjën mëmë, atje e kam edhe tim vëlla, gjithë mbuluar në një dhe".

Janë me dhjetëra e qindra interpretime nga këngëtarët e ndryshëm, kurse për kuriozitet dhe informacionin e juaj, kjo këngë është interpretuar në versionin origjinal edhe nga këngëtarët që nuk janë me origjinë shqiptare. Tek kënga "Kjani trima" me rastin e vdekjes së Skënderbeut, që merret si një humbje e pazëvendësueshme për ruajtjen e krishterimit në trojet arbëreshe dhe mëtanë detit Adriatik dhe Jon, poeti i këngës e thotë në mënyrë brilante duke treguar atë humbje në mënyrë rrëqethëse: "Më thajti gjunjët dhe më ngriri dejt... Kjani trima të gjithë me lot, se iku dielli që na bëri dritë". Një këngë shumë e bukur me nota mallëngjyese dhe e realizuar me shumë ndjeshmëri e që ishte pjesë edhe e këtij programi në Viti.

Por cili është motivi muzikor që përjetësohet në Këngët arbëreshe? Pjesa dërmuese e këngëve formësohet në tonalitetin mol ose minore. Melodia e këtyre këngëve fillon me motive të cilat ngërthejnë nostalgji, dhembje, drithërimë të cilat akcentohen përmes tekstit të shtjelluar me motive për mallin, dhembjen dhe humbjen e asaj që mbetet e përjetshme: malli për mëmëdheun. Motivet e këngëve valorizohen në orkestrime dhe narracionin tekstual. Zakonisht në versionet origjinale këto këngë përcillen me kitarë e fizarmonikë si bazë harmonike dhe melodike, shpesh herë me mandolina-

ta e më vonë edhe me instrumente të tjera, siç është violina, por edhe instrumentet e tjera ritmike: defi, me gjuhën origjinale tamburini dhe çuditërisht në vallëzime edhe lodra. Në debatet e logjikës akademike e kulturore, ekzistojnë diskutime lidhur me frymën e kësaj këngë që shpeshherë i përshkon logjika e narracionit muzikor me tinguj lamantose dhe të brumosura me vaje të shtjellimit muzikor. E logjikshme është kjo ndjesi, sepse të frymës së tillë i hasim te popujt ku dominon ndjenja e arratisjes nga dëbimet e formave të ndryshme të represionit: duke filluar nga ato fizike, pastaj kulturore dhe asaj fetare. Arbëreshet e ruajtën konfesionin e tyre. Ka shumë fakte që argumentojnë këtë, por që ne nuk do të ndalemi për eksploruar më tej.

Ritmi që anon kah forma e valsit

Duke gjurmuar në rrënjët e këngëve arbëreshe, që edhe pas qindra vjetëve ende i hasim të freskëta me interpretime nga më të ndryshmet, por edhe të modifikuara e të përshtatura kohës, ndalemi tek mënyra e këndimit nga solistët më në zë që i ka pasur dhe i ka sot skena muzikore shqiptare. Ndalemi, për shembull, te interpretimi fantastik i solistes primadonë, Vaçe Zela me këngën "Moj e bukura Arbëri", pastaj Elhaida Dani, po ashtu me këngën "Moj e bukura Arbëri", Tringa Rexhepi soliste nga Gjilani që jeton në Kanada e shumë të tjera. Viojnë këngët: "Moj e bukura More" nga Inva Mula, e njëjta kënga nga Elsa Lila, një interpretim fantastik, pastaj këngëtarë shqiptar nga Zvicra, Gjon's Teras, apo Gjon Muharremaj, që u kurorëzua me vendin e tretë në Evropë dhe para fundit, pastaj Elina Duni, në mënyrën e vet origjinale e vijojmë tek kënga: "Një ditë u ndodha të veja të shkëmbi" e super hiti: "Vajta kalova", të interpretuar me dhjetëra këngëtarë më të mirët shqiptar e deri tek Ardian Trebicka "O

yll i bukur" e shumë të tjerë. E veçanta e këngëve të këtij nënqielli mbetet ritmi në taktin apo masën 3 të 4 të formës së valsit. Tonaliteti i realizimit të tyre varet nga zëri i interpretative dhe vokacioni i tyre i preferuar. Kurse orkestrimet e këngëve janë të harmonizuara dhe të përshtatura, varësisht nga potenciali i orkestruesve dhe shija e tyre kontrapunktike dhe harmonike.

Shprehja muzikore që kërkon një origjinalitet të theksuar...

Këngët arbëreshe janë origjinale dhe ky origjinalitet mbetet përkushtim i detyrueshëm i gjithë atyre që kanë shfaqur dhe shfaqin dëshirën që të jenë pjesë integrale e këtyre krijimeve. Nuk është fjala vetëm te muzika, por edhe tek interpretimi i tyre, kostumet dhe veçanërisht teksti i përfaqësuar në këngë. Çdo mosnjohje e gjuhës dhe origjinalitetit arbëresh, mund të rrëshqas në lajthitje tekstuale, madje deri tek elementet groteske për shkak të mosnjohjes dhe problemeve të theksit të këtyre këngëve. Jemi dëshmitar te një pjesë e solistëve në një periudhë më parë kur kënga arbëreshe merr dimensione më të theksuara në skenë dhe nxirret nga margjina. Shumë solistë nuk njihnin domethënien e tekstit dhe pastaj ato krijonin konfuzion përmbajtësor. Fjala është tek kënga "Vajta kalova", kur në refrenin e kësaj këngë solistët që nuk kuptonin gjuhën dhe kuptimin origjinal të shprehjes, dilyn në një jo kuptimësi dhe krijonin kaksounde tekstuale si për shembull: Në vend të fjalëve "E lule lule mace mace... e unë pe ty o dale pace....", ata këndonin "E lum e lum për fatin tonë se zemra ime po vajton.... etj! Këtu komentet janë të tepërta. Edhe kostumet kanë një histori të begatë. Larushia e tyre e ngjyrave dhe me një kultivim në skenë, pastaj gracioziteti i lojës dhe i shprehjes, e bëjnë këtë thesar të veçantë dhe shumë të dëshiruar në skenat e koncerteve. Ritmi i përafërt me tarantelat e kohës, si një nga format e kultivuara skenike në vendet e qytetëruara, por edhe mënyra e lojës dhe e shtjellimit skenik, këto valle arbëreshe u joshën edhe nga shumë koreograf, të cilët me dashuri i qasen dhe i vendosin në skenë për ansamblet profesionale shqiptare. Por, këto tipare karakteristike me shumë dashuri, përpunohen edhe në ansamblet ndërkombëtare, siç na ka rastësisë t'i shohim edhe në SHBA e gjetiu. Kjo është edhe një dëshmi se kënga dhe vallja arbëreshe është ende e freskët dhe shumë interesante edhe pas kaq shekujve. E thash edhe në fillim, se çdo tentim të futesh në eksplorimin e tyre, të shfaqen argumente të fuqishme se ky material muzikor kërkon një trajtim shumë më profesional dhe më të thukët nga ekspertët e fushave, sepse dimensionin e saj konsideroj se është fundamental për muzikën shqiptare.

NUK KAM KRIJUAR KURRË SE DUHET, POR SE DUA

Si poete tashmë kam lexuesin tim që pret vazhdimisht nga unë, jo vetëm në krijimtari, por edhe si grua që vazhdimisht shfaq hapur mendimin për tema të ndryshme tabu të shoqërisë shqiptare



Intervistoi Avni HALIMI

Rita Petro është një shkrimtare, e cila me çdo botim zgjon kureshtjen e lexuesve gjithandej hapësirave shqiptare. Rita, njëkohësisht është edhe botuese e suksesshme, përkatësisht drejtuese e botimeve në ALBAS. Është autore e disa veprave poetike, ndër to më e shquar vëllimi me poezi "Vrima". Së fundi botoi romanin "Lindur së prapthi", vepër kjo që u prit shumë mirë jo vetëm nga lexuesit, por edhe nga kritika. Krijimet e Ritës janë përkthyer edhe në disa gjuhë të huaja dhe është fituese e disa çmimeve.

HEJZA: Rita Petro është ndër të paktat krijuese që di të rilindë në mënyra të çuditshme. Kjo ju bën Ju ndër shkrimtarët më të guximshme aktualisht në letërsinë shqiptare. Me "Vrimën" Ju u rilindët e pjekur dhe e guximshme për të rrëfyer tashmë se, megjithatë, jeni "Lindur së prapthi"!

R.PETRO: Po, ishte një rilindje. Mua si krijuese më duhet kohë e gjatë nga një lindje në tjetrën, për t'u mbarsur e, aq më tepër, për ta mbajtur pastaj farën e krijimit brenda trupit tim. Nuk kam krijuar kurrë se duhet, por se dua. Nuk kam krijuar kurrë se më pret lexuesi apo se çfarë pret ai prej meje, por se vetja ime rimbushet për të çliruar energji. Në këtë kontekst, ndikimi i lexuesit tek unë është pothuaj i pandjeshëm. Nuk më bën as më të frikësuar, as më të guximshme. Unë jam kjo që jam, me mbarsjet dhe lindjet apo rilindjet e mia. Nga "Vrima" te "Lindur së prapthi" u deshën 7 vite të mira. Kalimi nga poezia në prozë më ka ardhur shumë natyrshëm. E kam nisur rrugëtimin me lirika romantike, vazhdova me lirika moderne dhe poemën e shkurtër "Këtu poshtë këndohet live", më pas me poemat e librit "Vrima", që anonin nga rrëfimi dhe epizmi, dhe ja tani një roman. Thjesht, ashtu m'u

ngjiz për të rilindur apo lindur përmes një vetërrëfimi artistik.

HEJZA: Të qëndrojmë te "Vrima", e cila ka mijëra labirinte deri tek "arka" ku rrinë të mbyllur ekstrakti i lirisë, nektari i kënaqësisë dhe përroi i estetikës, të cilët janë përbërësit kryesorë të jetës së lumtur. Bota rend pa reshtur nëpër këto labirinte, për ta gjetur këtë "arkë"! Ta kishte bota "Vrimën", do ta përdorte si "hartë orientuese" për t'i kaluar të gjitha labirintet! Po bota shqiptare? Me gjasë, shqiptarët e kuptojnë "Vrimën", por nuk dinë t'i lexojnë "hartat"?

R.PETRO: Sa bukur e shprehët metaforën e arkës, ku rrinë mbyllur ekstrakti i lirisë, nektari i kënaqësisë dhe përroi i estetikës. Ky labirint është së pari brenda trupit tonë. Më pëlqen të futem në errësirën e trupit tim. Të zbuloj labirintet e ndjeshmërisë më të thellë, të instinkteve që, herë pas here,

godasin me forcë kafkën tonë: bum, bum, bum, dhe na japin aq shumë dhimbje koke. E kam ndier këtë dhimbje të thellë dhe më është kujtuar miti për Zeusin, nga koka e të cilit lindi Athinaja, perëndesha e luftës. E ndjeva këtë dhimbje dhe shpërthimin, kur krijova heroinën e librit "Vrima". Ndaj, ajo është aq e ngjashme me Afërditën. Përherë e sfidon vëllanë e saj, të përkëdhelurin e nënës në bibilush, duke iu drejtuar se ajo është luftëtarja e babait. Heroina e Vrimës është edhe e mençur, edhe trime, dy armë të forta për t'i mbijetuar egërsisë së botës moderne dhe fosileve, konvencioneve shoqërore që mbart ajo prej së shkuarës. Heroina e Vrimës deri në moshën e rritjes kalon nëpër disa duar, që e thellojnë rrethin e labirinteve që duhet të kalojë për të arritur tek arka e lirisë. Nga duart e doktorit, që i pret litarin e mishit me të cilin ajo është e lidhur me Zotin e saj, kalon te duart e mamasë, pastaj me radhë te duart e babait, profesorit, mashkullit të parë, policit, gjykatësit, shefit, priftit, te të gjitha institucionet që mundohen ta rimodelojnë, përtej asaj si e ka bërë Zoti. Po ja ku ajo rebelon tashmë me femijën, si kanguri varur në marsup dhe përmes labirinteve të rrezikshme, arrin tek arka e lirisë apo te zona me rrezikshmëri të lartë. "Aty është liria, dashuria, kënaqësia e vërtetë? Aty?" - pyet ajo. Dhe përgjigjja i vjen: "Po. Përtej atij gardhi me tela me gjemba. A e kalon dot?". "Edhe tela me korrent po të ishin, do ta kapërceja", - thotë ajo. Dhe papritmas gjendet në parajsën tokësore. Ja, pra, që e kishin gënjyer. Se parajsë nuk kishte vetëm pas vdekjes, por dhe mbi tokë. Dhe për ta shijuar dhe ruajtur atë duhet të luftosh prapë e prapë, derisa energjia e Zotit të të marrë

përfundimisht në gji të tij. Po nëse je jashtë kësaj energjie, ti do të vuash nga vogëlsitë më të mëdha të së përditshmes, nga mungesa e lirisë që të bën të zvarritesh e jo të jesh një qenie e lumtur, e mbrujtur me liri.

HEJZA: Kohët e fundit, astronomët po zbulojnë se përtej "Vrimës" së Zezë ekzistojnë dhjetëra galaksi të tjera më të mëdha se yjësia që shohim në qiell. Pra, në rastin tonë, nuk është zbulim "Vrima", por ajo që fshihet përtej saj! Me gjasë do të na duhet shumë kohë për ta kuptuar.

R.PETRO: Përtej Vrimës, marrë në të gjitha kontekstet e saj, ka jetë. Truri dhe trupi ynë është i kufizuar. Pasi lindim, kufizohemi edhe më shumë nga kufijtë që na vendosin shoqëria me rregullat e saj, shkenca apo teologjia. Janë dy pyetje thelbësore në librin "Vrima". Në momentin që fetusi fillon të mbushet me gjak e ujë dhe të plotësohet me gjymtyrë, ai pyet: "Kush jam unë?! A ka të drejtë një fetus të mendojë?"

Ndërsa në një moment tjetër, kur heroína e mbarsur e "Vrimës" hapet 10 cm dhe pret të dalë fëmija, por në fakt ka lindur trurin e saj, pyet: "Truri im është ky në duart e mia larë në gjak? A është e mundur të mendoj me trurin jashtë?"

Neuroshkencëtarët këmbëngulin se përvoja nuk mund të reduktohet vetëm në veprimet e trurit. Mendja është energji dhe gjeneron energji përmes të menduarit, ndjenjës dhe zgjedhjes. Është energjia jonë, pa të cilën trupi dhe truri fizik do të ishin të padobishëm. Në këtë libër, nga një orgazëm e zakonshme kam kaluar te orgazmat kozmike, prej të cilave lindin galaksitë, te orgazmat që sjellin shpërthimet e vullkaneve në tokë, te orgazmat e larta të njerëzve që çlirojnë mrekulli, dhe këta janë gjenitë njerëzore në të gjitha fushat e dijes. Por, jo vetëm gjenitë, edhe njerëzit e zakonshëm mund t'i ndiejnë këto orgazma truri e të mos mjaftohen vetëm së qeni qenie kafshërore, ku çlirimim e shohin vetëm te drithërima e momentit vulgar dhe jo te drithërima e vërtetë, ku marrin pjesë të gjitha qelizat e



qenies sonë dhe kjo na sjell jo vetëm një kënaqësi fizike, por dhe shkrirje me universin. Kjo na bën qenie më të mira në jetën e përditshme, ku njerëzit detyrohen të martohen në kishë para të ftuarve "të ngjuar me kohë" dhe, pas kësaj, detyrohen të bëjnë seks "me duar e këmbë lidhur". Ka aq shumë përtej "Vrimës", sa që kur dëgjoja se si dhe shumë intelektualë ranë pre e psikozës së turmës, thosha me vete: "Fali, o Zot, se nuk e dinë ç'po bëjnë!". Po edhe sikur këto vargje t'i përkushtoheshin thjesht vaginës, a nuk është një mrekulli ajo vrimë prej nga vjen jeta e gjithsecilit prej nesh, që ne femrave na e krijoi

Zoti në trup?!

HEJZA: Sa romantike në krijim mund të jetë një krijuese, e cila brenda vetes ndien rebelim kundër rrethit, kundër gjithçkaje që e rrethon, madje edhe kundër atij apo asaj me të cilën e ndan një nënkresë?

R.PETRO: Jam romantike e lindur në jetë. Po sipas mënyrës sime. Jo sipas skemave të krijuara në kokat e disa vajzave apo grave. I dashuri sjell befasi lule të mrekullueshme, ulet në gjuhë për t'i dhënë unazën, i bën befasi një darkë në dritën e qiririt me verë të kuqe dhe më

pas vijnë netët intime veshur me mëndafsh e dantella një pëllëmbë. Sigurisht janë të bukura këto, por ndonjëherë mbetemi aq bosh dhe nuk na lumturojnë kur ndodhin. Pse? Se mungon shpirti, ajo që është origjinale mes një çifti. Unë romantizmin e kam lidhur përherë me dëshirën "perverse" për të qenë në xhunglën e dashurisë si na ka lindur nëna bashkë me partnerin, gjë që e kam të dallueshme dhe në poezitë e mia. Intimiteti nuk kërkon sforcime për t'u dukur super e bukur, super elegante, super inteligjente, super melankolike. Sidomos kjo e fundit, melankolia e tepruar e vdes



romantizmin. Dhe meshkujt, sidomos inteligjentët, i vel apo i bën të ftohtë kjo gjë. Shumë femra nuk e kuptojnë këtë dhe vazhdojnë me ëndërrimet për dashurinë platonike.

Rebelizmin në art unë e kam më të drejtpërdrejtë se në jetë. Në jetë jam shumë e kujdesshme, e duruar, tolerante dhe aspak arrogante. Por nga ana tjetër, jam e rrezikshme se marr vendime të forta. Mund të rrezikoj shumë për hir të asaj, që të mbroj cakun e lirisë time personale. Cakun e kam të ngushtë prej tolerancës dhe vetësakrificimit, por po m'u prek ky cak, nuk lejoj askënd, as fëmijën tim, as partnerin e nënkresës. Pastaj është vendimi i tyre, nëse më pranojnë apo jo. Për fat, më kanë pranuar kështu si jam. Dhe jam shumë e lumtur që edhe mjaft lexues më duan kështu siç

jam. Madje marr shpesh mesazhe të tilla: "Aman mos ndrysho. Je kaq mirë kështu siç je!".

HEJZA: "Lindur së prapthi" është një konstruksion piramidial i ngritur me kujtime, të cilat i ke për provokim; për ta provokuar mbamendjen për të kaluarën e trishtë të shqiptarëve, atëherë kur detyroheshin të lindnin së prapthi, të jetonin së prapthi, të vdisnin së prapthi! Duke lexuar romanin Tuaj të fundit, seç krijohet një pershtypje se, lindja së prapthi, të paktën, estetikisht qenka e bukur. Ishte ky qëllimi kur i frytë këtij krijimi?

R.PETRO: Sigurisht që estetikisht është bukur. Nuk ka art pa provokim, pa rebelim, pa nerv. Ndryshe çdo shkrim

tjetër mund të jetë kronikë, histori, filozofi, shkencë, por jo art. Heroinën e romanit tim, që shpesh duket që jam unë, e ka ndjekur gatë gjithë kohës së rritjes ky etiketim apo nofkë. Pra, nis si bullizëm brenda familjes. Edhe sikur ajo të bëjë gjëra normale, nuk i shpëton dot këtij etiketimi. Aq shumë i është përsëritur nga familja e më pas nga mësuesit apo të rriturit e tjerë, sa ajo më pas e shan edhe veten: "Kot s'thonë për ty që je së prapthi". I ndodh kjo në një moment kur "shtriga e letërsisë" e detyron të bëjë një poezi për flamurin e larë me gjakun e dëshmorëve, dhe asaj sa përmendet fjala gjak, i shkon mendja te gjaku i menstruacioneve që sapo i kanë ardhur dhe i dhemb barku.

Nga ana tjetër, po kush ishte së mbari në atë kohë? Njeriu i ri me moral të gënjeshtërt

komunist?! Kur jemi fëmijë, na pëlqen ta shohim botën së prapthi. Nuk mund ta harrojmë imazhin e një përralle, ku dikujt iu shkrep të ecte me duar dhe kur u fut në një fshat, shumica e njerëzve filluan ta ndjekin duke ecur pas tij me këmbët lart. Gjithçka së prapthi duket e idealizuar. Kulmet e shtëpive të ulëta dhe të varfra dukeshin sikur preknin qiellin dhe ndërtesat aq gjigante. A nuk duhej parë bota e idealizuar, që të mund të mbijetoje në një vend, ku t'i prisnin krahët ende pa të të shkuar mendja te fluturimi?! Ndaj lirisë mund t'i afroheshe sado pak, veç nga ky këndvështrim.

HEJZA: Ngritja e përjetimeve personale në kolektive, krijuesja si personazh kryesor i rrëfimit që na del si fat personifikues i femrave shqiptare në diktaturë të egër, është një ikje nga jetëshkrimi apo një fiksjon i gatuar me të vërtetat e përjetuara. "Lindja së prapthi" mos është një roman mbi guximin dhe fuqinë biblike të femrës shqiptare?

R.PETRO: Me apo pa qëllim, heroina e librit tim është një femër që, për hir të edukimit dhe rrethanave të saj jetësore, nuk ka shans të bëhet viktimë e askujt, madje as e sakrifikuar për hir të dikujt larg stereotipave me personazhe femrash viktimë ose të vetësakrifikuara, ose prostituta të rrethanave të caktuara. Heroina ime është si shumë e shumë vajza të tjera të asaj kohe me dilemat e rritjes, dëshirat sensuale që nuk i njuh, por i shpreh, me guximin që nuk pret "ta gjuajnë", por është ajo që "gjuan" djalin më interesant për të, me ambicie për të arritur njohjen e dukurive përmes zbulimit të saj dhe jo përmes një edukimi të ideologjizuar. Për shembull, ajo zhvishet me naivitet para Shkrimtarit të Madh, me dëshirën të kthehet në personazh të romaneve të tij, por refuzon kategorikisht provokimin e redaktorit, i cili do që të shfrytëzojë dëshirën e saj për të botuar poezitë në gazetën letrare. Dhe si këto vajza kishte plot në atë kohë, ka plot në moshën time që, megjithëse i përkasin brezit që u rrit në diktaturë, sot janë mjaft mendjehapura dhe kontribuuese në shoqërinë tonë.

Pra, a nuk paskan nevojë këto vajza e gra të jenë të përfaqësuar në letërsi?! Dhe jo vetëm të viktimizuar apo prostitutat, viktimat të të tjerëve?! Sigurisht ky personazh nuk u sajua nga unë, e gjeta te vetja dhe mes rrethit ku jetoj.

HEJZA: Ku e shihni Ju dallimin në mes të lirisë politike dhe lirisë krijuese. Cila është më jetike për një krijues?

R.PETRO: Absolutisht liria krijuese. Por, shkrimtari zgjedh të bëjë një profesion të caktuar në jetë, për të ardhurat e tij financiare. Dikush mund të zgjedhë politikën. Ama, të mos harrojmë se nuk ka krijim pa politikë brenda, edhe sikur të shkruhet për temën e seksit. Politika, në njëfarë mënyre, t'i lidh duart dhe këmbët, të krijon vetvetiu autocensurë. Duhet të jesh tepër i fortë, tepër i paanshëm dhe të mos ia kesh frikën gjykimin për hir të profesionit.

HEJZA: Si krijuese e guximshme e letrave shqipe, si femër që ka tejkaluar tabunë, që nuk lodhet për t'i zbërthyer paragjykimet, etiketat, tevona, po aq e fuqishme në menaxhim të Shtëpisë Botuese "ALBAS", këmbëngulëse në qasje të shëndetshme ndaj librit, cili është raporti i shqiptarëve ndaj librit, jo vetëm si botim, por edhe si mjet leximi? Në bazë të disa analizave dhe statistikave, kemi ngelur si popull pa dëshirë dhe pa shije leximi!

R.PETRO: Si poete tashmë kam lexuesin tim që pret vazhdimisht nga unë, jo vetëm në krijimtari, por edhe si grua që vazhdimisht shfaq hapur mendimin për tema të ndryshme tabu të shoqërisë shqiptare. Si botuese shoh që ka ndryshim. Autorët shqiptarë po kthehen në vëmendje të lexuesit, kjo edhe për shkak të disa botuesve seriozë që po investojnë në këtë drejtim. Dhe ka disa autorë bashkëkohorë që i kanë kapërcyer kufijtë, pavarësisht se jetojnë në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoninë e Veriut apo në diasporë. Sa për shijen e popullit, apo më mirë të masës së madhe të atyre që zgjatin dorën drejt librit, edhe unë mendoj se le për të dëshiruar. Të vjen vërtet keq që shkrim-



tarë nobelistë kanë një lexues aq shumë të kufizuar. Ndërsa rrëfimet melodramatike apo librat se si të bëjnë të pasur botohen e ribotohen kaq shpesh. Mendojmë si botuese, e mbështetur dhe nga redaksia apo bordi i përbashkët Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut që miraton titujt e rinj të çdo viti, të ruajmë lart standardin e botimeve cilësore, si në botimet për fëmijë, ashtu edhe për të rritur të zhanreve të ndryshme. Më vjen mirë që seritë e Klasikëve për fëmijë përkthyer nga origjinali, seria Më quajnë... me personalitete shqiptare; seria Klasikë dhe Modernë (me autorë botërorë dhe shqiptarë) për të rritur, botimet akademike apo kulturologjike po pasurohen dita-ditës dhe, ndonëse me shitje të ngadalta, na bëjnë të ndihemi mirë, pasi vlera e një libri të mirë është themeli në godinën e kulturës shqiptare.

HEJZA: Si krijuese dhe si botuese jeni ndër të rrallat që e njihni, të themi, mirë botën letrare të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! Së këndejmi, a ndani edhe ju mendimin se politikën shtetërore (si të Shqipërisë, ashtu edhe të Kosovës) janë tepër shumë të ftohta për sa i përket stimulimit dhe përkrahjes të krijuesve shqiptarë të këtij shteti dhe, rrjedhimisht, edhe më të ftohtë ndaj krijuesve të Lug-

inës, të Malit të Zi, të diasporës. Stimulimi qeveritar i shtëpive botuese të Shqipërisë e Kosovës për të botuar krijues nga viset etnike, do të ishte një hap milimetrik drejt bashkimit kulturor kombëtar?

R.PETRO: E thatë shumë mirë. E kam vërejtur një gjë të tillë. Shpesh ndarjet janë aq të theksuara, sa të vjen keq. Ata s'janë tanët, jo, mos i mbështesni, janë të Shqipërisë apo e kundërta. Janë të Kosovës, janë të Maqedonisë së Veriut, janë të diasporës etj., etj., ne të Shqipërisë kemi politika të tjera etj. etj. A thua se po flasim për ndonjë armik. Shumë e turpshme. Kjo duhet të marrë fund prej politikave shtetërore të përbashkëta që thoni dhe ju.

HEJZA: Si shtëpi botuese, sa jeni të gatshme të sfidoheni duke iu rrekur projektit të unifikimit të kolonave të letrave shkollorë të të gjitha niveleve arsimore! A mendoni se keni fuqi për ta nxitur një projekt të tillë të prirë nga një komision prej kritikëve e shkrimtarëve mbarëkombëtarë?

R.PETRO: E kujtoj me shumë mall kohën kur, para se të ndodhte lufta në Kosovë, kam qenë pjesë e një grupi pune të përbashkët nga të gjitha trevat shqiptare, ku arritëm një punë të shkëlqyer në unifikimin e kurikulave për lëndët me

rëndësi kombëtare, si letërsia dhe gjuha shqipe. Sot që kufijtë janë zhdukur, duket sikur jemi vetë ne që i vendosim njëri-tjetrit sinorë të tillë. Absolutisht duhen komisione të përbashkëta, të cilat mbi kriteret të përcaktuara mirë të sugjerojnë kolanat e lekturave shkollorë, si dhe kurrikula të përbashkëta. Nuk ka letërsi kosovare apo e Maqedonisë apo e diasporës. Ka vetëm letërsi shqiptare. Sa për fuqinë që të ndryshojmë diçka, nuk e di. Shpesh politikën shtetërore na shohin si kundërshtarë, si ente private, që kemi qëllim vetëm të fitojmë dhe jo që me investimet tona i bëjmë mirë kulturës së një vendi. Po prapë ka shpresë për bashkëpunime të frytshme, siç dhe kanë ndodhur.

HEJZA: E juaja si shkrimtare është që të shkruani ndërsa, për të lexuar, le të urdhërojë kush të dojë! Mbase nxitja institucionale apo "e dhunshme" për shprehi leximi nuk i bën mirë asnjë populli!

R.PETRO: Kur nxitja për lexim kthehet në mbështetje klanore është jashtëzakonisht e dëmshme. Por... ka gjithnjë një POR të fortë. Lexuesi mund të gënjehet për herë të parë nga një çmim zyrtar i trumbetuar fort. Po nuk gënjehet për herë të dytë, nëse ky apo ai shkrimtar nuk di të bëjë letërsi të mirë. Nëse i jepet çmim dikujt që ka apo s'ka 5 lexues të tij, kur letërsia e këtij apo kësaj nuk trondit asnjë zemër apo shpirt njerëzor, po zhduket si hije, përgjegjësia i takon komisionit të mbështetur prej ministrive përkatëse të kulturës. Sot rrallë bëhen analiza të vërteta kritike. Sot ose shahen e denigrohen, ose thuren lavde për shkrimtarët. Po shumë shpejt mendoj se do të vijë dita që do të ndryshojnë kriteret për një kritikë të vërtetë letrare. Koha ka treguar përherë se cili shkrimtar apo cila vepër e mirë mbetet për shkak të karakterit të saj universal.

HEJZA: Çfarë po shkruani kohëve të fundit? Me çka do të na befasojë ëndshëm Rita Petro?

R.PETRO: Poemën e mungesës po e shkruaj tani në kokë.

Për frymëzimin, procesin krijues, kohën...

ËNDËRRIMI I PAVDEKSHMËRISË SË VEPRËS

IBRAHIM KADRIU

Shkrimtari në rend të parë i takon kohës në të cilën jeton dhe vjel atë që duhet të vjelët për tërësinë e një veprë apo tjetër. Është e natyrshme që frymëzimi të jetë parakusht, ndryshe veprës do t'i mungojnë efektet kreative për t'u futur në lagjen e të mirave letrare.

Frymëzimi kujdestaron para ndjesive, të shkrimtarit, kur ai gjendet përballë temës të cilën synon ta shtjellojë, me të cilën (them për vete) jeton gjatë dhe në pamundësi që të lirohet nga ajo pa ia kushtuar kohën e duhur, duke e sfiduar atë, siç thoni ju. Më duket interesante mendimi që vepra e krijuesit të çlirohet nga koha për t'u bërë e pavdekshme. Natyrisht, vepra me rastin e formësimit, vetvetiu çlirohet jo vetëm nga koha kur shkruhet, por edhe nga autori, nëse e arrin limitin letrar të bëhet e pavdekshme.

Shkrimtarët e ëndërrojnë pavdekshmërinë e veprës së tyre, që do të ishte mrekulli, por për këtë patronati i takon kohës së ardhshme, të cilën nga ky

kënd ku po jetojmë nuk mund ta vlerësojmë. Pavarësisht kësaj situatë, obligimi i shkrimtarit është që ta shtyjë angazhimin letrar sipas konditave që ia cakton intuija, por për këtë, kuptohet, frymëzimi e ka, ose duhet ta ketë, një ndër rolet me rëndësi në mënyrë që vepra të jetë e plotë. Për shumicën e veprave të mia frymëzimi ka ardhur nga faktet historike të së kaluarës shqiptare, por edhe nga përditshmëria, nga rrethanat sociale-politike.

Në kundërthëniet në të cilat shpesh gjendemi – temat janë të gatshme nga të cilat, në cilësinë e shkrimtarit, intrigo-hem dhe merrem me të tilla tema, siç jam marrë në romanet: "Loja e fundit", "Përtej binarëve", "Ata dy të burgjeve", "Shtëpia e fantazmave", "Vdekja e Anilës", etj. Momentalisht është në proces romani me titull "Zbritje në dekada", që tematikisht është në vazhden e "Misionit rus"...Pajtohem se sot rrethanat aktuale paraqesin pengesë të madhe për krijuesit, por derisa merrem me temën e caktuar jam krejtësisht veç me veten, pa e lodh kokën për pengesat e mundshme.



Fjala e poetit


PSE SHKRUAJ!?

Nuk ka pra poezi të madhe ose të vogël, të mirë ose të keqe, po vetëm poezi që i përshtatet plotësisht potencialit jetësor dhe poezi që s'i përshtatet

Lasgush PORADECI

Pse shkruaj, pse parapëlqej të shkruaj vargje dhe jo prozë? Kur them vargje, kuptoj që duhet të jenë të përsosur nga arti. Vetëm këto të përsosurit rrojnë (dhe mezi dhe këto). Të papërsosurit vdesin. Sepse gjuha ndryshon pas 500 vjet. Ajo më s'është siç ishte. Është ligji i saj fiziologjik dhe shpirtëror (siç është zhvillimi i njeriut). Bibla e Lutherit për shembull, e shkrojtur para 500 vjetëve, më s'do mundte të përdorej prej gjermanëve pa i-u bërë përpunime gjuhe. Gjithashtu dhe përkthimet e "përsosura" mjaftojnë për një kohë të gjatë, po dhe kjo kohë e gjatë njëherë mbaron. Vetëm që kur përkthimi ose një vepër origjinale janë të mira, kanë mundësi të qëndrojnë më gjatë. Pse? Sepse dyqe qënë të përsosura, të derdhura si në mermer, pas mbarimit të kohës sa qëndron gjuha e tyre (p.sh 500 vjet), ato mund të ripunohen në themel të formës, të derdhjes së tyre të parë, pa çformuar derdhjen e parë. Poezija ka mundësi të qëndrojë më shumë se sa proza, sepse poezija ka një formë më skulpturale, një derdhje më të pandryshuar. Për sa i përket toskërishtes, kjo siç duket, një herë mund të mënjanohet prej gjuhës së "mesme" (e cila e mesme, s'është veçse një gegërishte e zbutur, e zbutur nga influencimi armonios i toskërishtes). Gegërishtja ka energji fizike, toskërishtja ëmbëlsi shpirtërore. Dyqe bashkuar gegërishten me toskërishten, gegërishtja gjith dyqe mos humbur forcën, energjinë, fiton dhe harmoni, ëmbëlsi (si gjuhë e "mesme" me karakter geg). Lufton pra forca fizike me harmoninë shpirtërore, trupi me shpirtin. Forca si një gjë brutale, do të fitojë (lëndërisht) përmis shpirtin, do të mbetet (mbase) gjuha e "mesme" geqe, sepse gjithnjë forca fiton përmis shpirtin. Ky fitim është lëndërisht do kemi si gjuhë gegërishten (e "mesme"). Po një gegërishte të

shpirtëzuar me influencën e toskërishtes. Shpirtërisht toskërishtja nuk humb, shpirti do duket në ëmbëlsinë, harmoninë, bukurinë e gegërishtes se "mesme". Sa më e fortë, më e fuqishme, më e shumanshme të jetë toskërishtja në harmoninë e saj, aq më shumë do të ndjehet fryma e saj mirëbërëse në gegërishten (e "mesme"). Edhe unë mendohej, me fuqitë e mija, t'ia nxjerr në shesh toskërishtes potencialitetin e saj shpirtëror, bekimin e harmonive të saj, dyqe bërë vargje të përsosur në harmoni. Harmoni nuk është forma (forma e përsosur s'është kurrë art, mund të jetë zejtar, po jo art). Harmonija ime është manifestimi (me anë të vargut) i vetë jetës dhe i vetë botës shqiptare, së kristalizuar në forma të dukshme shpirtërore, të cilat janë simbole të jetës dhe të botës. Prandaj rima ime identifikohet me fondin, prandaj formë e fond janë një: janë realiteti shpirtëror i shfaqur identikërisht me anën e poezisë. Prandaj rima ime nuk kuptohet kurrë që është rime, po tretet në simbolin e jetës të cilin ajo e shpreh me atë simbol të përsosur. Ky është arti im, një art shqiptar. Kur them rime, e bashkuar me fondin, nuk kuptoj vetëm rimen, por dhe ritmin dhe masën me stilin e jetës, të jetës shqiptare. Është jeta shqiptare, morali etik shqiptar që çfaqet me atë simbol poetik, sepse vetëm gjuha shqipe (e derdhur në poezi) me tingujt frymorë dhe lëndorë të saj ka mundësi të shprehë harmoninë specifike së poezisë s'ime. Sa më e përsosur është një poezi, ajo është (njëkohësisht) dhe aq më e fuqishme, domethënë aq më shumë përmban potencialin e moralit frymor shqiptar. Që dua të dali poezia ime (e cila është "harmonija" ime në kuptimin e rrëfyer më sipër) sa më potenciale, kjo nuk shkaktohet prej volles t'ime individuale, po prej vet potencialit të jetës dhe botës, i cili me vitalitetin e tij të plotë e shtyn vetveten që t'a çfaq, t'a shprehë më plotërisht. Shprehjen ky vitalitet e di



(nga vet natyra e tij) e do të jetë njëjt me potencialitetin e vet të tij. Nuk ka potencial më të madh ose më të vogël në poezinë e përsosur, po ka vetëm potencial të plotë, domethënë vetëm gradën supreme të potencialitetit vital të jetës së racës. Jeta (p.sh në manifestimin e saj si "dashuri") ka vetëm një potencial, domethënë ajo është e përsosur, domethënë e fortë absolutisht. Prandaj dhe poezia duhet të shprehë jetën me simbolin poetik - në maksimumin e saj, në potencialin absolut të saj. Atëhere poezia është e përsosur, perfekte. Kur s'është e përsosur: kur s'ka fuqinë supreme, poezia nuk s'e është e metë, po s'i përshtatet, s'i përputhet potencialit moral të jetës, pra s'është poezi, nuk përfaqëson vitalitetin integral të jetës dhe të botës, potencialin absolut. Nuk ka pra poezi të madhe ose të vogël, të mirë ose të keqe, po vetëm poezi që

i përshtatet plotësisht potencialit jetësor dhe poezi që s'i përshtatet. Poezija që i përshtatet, është POEZIJA, ajo që s'i përshtatet NUK është poezi dhe pra duhet të vdesë, të mos rrojë-sikundër dhe s'rron po humbet. Pse duhet të jetë poezia e fortë, potenciale, e përsosur? Sepse vetëm dyqe qënë potenciale, ka fuqinë me vete që të transmetohet më tej, që të transformojë potencialitetin e jetës më tej në të ardhmen njerëzore... Transmetimi moral i jetës (me anë të simboleve poetike) lot një rol aktiv dhe jo absolut. Vërtet, se gjithë poezia sado e fortë, humbet (edhe përkthimi i bukur i Shakespeare-it prej Schlyel Tieck, ose përkthimi i Biblës prej Lutherit) nuk rron përjetë, sado i përsosur që të jetë. Sepse gjuha ndryshon me kalimin e kohës, dhe gjuha si dhe stili i çdo përkthimi duhet ndrequr, siç ngjet me gjermanishten e Biblës së Lutherit që sot e 500 vjet përpara.

DRITA QË SHKËLQEN NË QIELL LETËRSIE

Poetja njohu dy sëmundje të rënda: njëra personale dhe tjetra personale e shoqërore. Sëmundja e parë quhej kancer. E dyta komunizëm



Salajdin SALIHU

I. Viti 1981. Shqipëri. Vendi më i mbyllur i botës. Një muze ateist ku ishte përjashtuar metafizika, pa të cilën arti është asgjë. Se arti (si Gilgameshi, që ishte njeri e hyjni) e përmbledh në botën e tij të dukshmen e të padukshmen; realitetin e shajninë; tokësoren, qielloren dhe infernalën; parajsën e ferrin; engjëjt e djajtë; Kainin e Abelin; Judën e Krishtin; protagonistin e antagonistin; agun e muzgun; ëndrrën e zhgjëndrrën; të mundshmen e të pamundshmen...

Në këtë vit, në spital onkologjike, jepte shpirt një vajzë 23 vjeçare. E vetme. Pa askënd pranë. E ëma e saj më kot i adresonte lutje mikeshës së dikurshme, Lejdi Makbethit, që t'ia mundësonte, së paku, në çastet e fundit, të ishte pranë së bijës. Asnjë përgjigje. Makbethët e Shqipërisë ishin të pamëshirshëm.

Ne vetëm mund ta paramendojmë si mund të jetë ndër një nënë në kësi çastesh. Gjendja e nënës, mbase, më përafërsisht, përshkruhet nga e bija (për ndonjë situatë tjetër të ngjashme):

"Atë ditë ajo dukej krejt e thinjur.

Sytë e errët,

Si gjithnjë fshihnin dhembjen.

E kish harruar atë ditë zemërimin.

Atë ditë ajo ishte

Vetëm nënë."

Nëse vajza nuk do të ishte në amshim si 23 vjeçare, sot do të ishte 63 vjeçare. Mbase do të qeshte me vargjet rinore: "Dhe e di se kurrë s'do bëhesh nënë". Do të shkruante poezi. Do të botonte libra. Do të ishte emër i çmuar në letërsinë shqipe. Kjo është vetëm imagjinatë. Dihet se ajo është poete dhe emër i çmuar në letërsinë shqipe edhe pa moshën 63 vjeçare, edhe pa librat që nuk i arriti t'i shkruante.

II. Emri i saj është Drita Çomo (1959 – 1981). Dritë e veçantë e poezisë shqipe. Dritë që ka mbetur edhe pasi ka ikur nga kjo botë.

Libri i vetëm i saj, "Dritë që vjen nga humnera" (2004), është botuar pas vdekjes. Është libër më i çmuar se qindra libra për të cilët janë shkruar recensionet e studime.

Libri i Drita Çomos ka poezi dhe ditarin që autorja e ka shkruar derisa ishte në internim dhe në spitalin onkologjik.

Kjo qenie e pafajshme, e brishtë, shkruan për vuajtjen e saj. Vetëm ajo mund ta dinte se "ç'do të thotë të vuash, kur s'ke faj". Ishte e bija e Liri Belishovës dhe Maço Çomos. Të dënuar politikë.

Në sistemin totalitar vlejnjë ligjet mesjetare. Dënimi është kolektiv. Dënohen edhe fëmijët apo të afërmit e të dënuarve politikë. Dënimi kolektiv synon ta shuajë çdo disidencë. Se kur njeriu e mendon që rebelimi i tij u sjell fatkeqësi të pafajshmëve, atëherë e humb guximin për të bërë akt prej martiri...

III. Drita Çomo është njëra nga poetet më të mira që ka pasur letërsia shqipe. Poezitë e saj i shkroi dhembja, trishtimi, mërzia, por edhe dashuria.

Në poezinë e saj ka hije vdekjeje, dashuri siberiane, shpirtira prej akulli, qiell gri ose të errët, trishtim, mërzi, vetmi, vjeshtë, dhimbje, heshtje, pritje të ankthshme, por ka edhe jetë "kur gjithçka tjetër fle", ka shpresë për "ata që do të vijnë".

"Ecëm

me një të kaluar që s'e kishim jetuar

Dhe pa të ardhme.

Megjithatë jetuam.

Pikërisht për të kaluarën

Dhe pikërisht për të ardhmen.

E deshëm jetën. Thjesht.

Dhe e duam.

Në humbëtirën e kohës shtyjme monotoninë e ditëve".

Në kohën "pa asgjë të re" duhej të jetohej edhe për ata që do të vinin.

"Jetuam, që ata mos jetojnë si ne.

Që ata të kenë ëndrra të lira,

si deti;

Të mos e njohin ngushtësinë

makabre të qelive,

Që ata ta duan diellin dhe njëri – tjetrin

Dhe të mos u besojnë kaq shumë perëndive.

Që ata ta dinë çdo të thotë dhembje

Çdo të thotë të njohësh frikën dhe lotët

Dhe ta kuptojnë se... "Partia" dhe "Revolucioni"

Nuk mjaftojnë për ta bërë më të mirë botën".

IV. Drita Çomo është poetja shpirtçiltër në botën e egër dhe hipokrite:

"Sa hipokrite, net pa gjumë,

Njerëzit dhe vetes i flasin bukur

Njësoj në dashuri, në politikë

Të gjitha i mbështjellin me lustër".

Për të poezia ishte ëndërr, vegim i kaltër, zanë. Poezia ishte kudo pranë saj: në dhomë, në klasë, në spital. Kudo e shoqëronte "e përziera me ëndrrat, dëshirat, mendimet", që "lë prapa vetëm heshtjen".

Poezia e Drita Çomos dëshmon se për letërsinë është e parëndësishme mosha e poetit dhe sasia e librave të botuar...

V. Poetja njohu dy sëmundje të rënda: njëra personale dhe tjetra personale e shoqërore. Sëmundja e parë quhej kancer. E dyta komunizëm. Të dyja metastazojnë. E para në trup. E dyta në shpirtin e njerëzve. E para e shkatërron trupin. E dyta shpirtin.

"Në udhë të jetës së saj i kishin dalë herët, tepër herët, dy nga përbindëshat më të zezë të kohës: diktatura dhe kanceri", tha Ismail Kadare.

Drita Çomo iku nga kjo botë dhe kaloi në botën tjetër, në botën e artit, ku nuk të bëjnë asgjë as kanceri, as komunizmi.

POEZIA MBI TË VËRTETËN

Të shkruash poezi dhe për poezinë është ndër punët më të vështira. Poezia, në përgjithësi, është djersitje e shpirtit dhe si të depërtosh në shpirtin e poetit dhe të parafrazosh ndjenjat e tij/saj të brendshme kur edhe vetë poezia nuk ka arritur t'i pasqyrojë sa duhet ato

Metin IZETI

Filozofia e artit, në masë të madhe, është e mendimit se prapavija ontologjike dhe fenomenologjiko-historike e çdo arti është e përqendruar te "feja" dhe "bota shpirtërore". Artisti është një qenie që ka lindur dhe vepron në kuadër të një platforme qenësore; ndërsa arti është aftësia që i është dhënë.

Lënda e veprës artistike është e vendosur ose e krijuar që më parë te dukshmëria, dhe si pasojë e këtij realiteti vepra praktike apo intelektuale e artistit është e mbështetur në imitimin e kësaj lënde që ekziston qysh herët në botën e dukshme. Krahas kësaj, edhe vetë subjekti i veprës artistike bën pjesë në grupin e lëndëve të dhëna, pra të krijuara. Aftësia nëpërmjet të cilës artisti nxjerr në dukje veprën e tij, nga intelektualiteti te pragmatika, po ashtu është e dhuruar nga Fuqia Krijuese, dhe paraqet dhunti hyjnore. Shikuar nga këndvështrimi njerëzor, vepra artistike është një "takim i përsosur gjërash të dhuruara". Karakteri i dhuruar i artit është një prej cilësive thelbësore të Artit të Shenjtë dhe zë një vend të rëndësishëm në këtë disiplinë. Arti i bazuar te "dhuntia" ndryshon në thelb nga arti i bazuar te "e arritura". Për rrjedhojë kjo çështje bën pjesë ndër ato subjekte që janë mjaft të diskutuara në epistemologji, për nga aspekti i "dijes" dhe "nxënies së dijes".

A është dija një gjë që arrihet, fitohet, apo dhurohet? Ndryshimi kryesor mes mistikëve dhe racionalistëve në lidhje me thelbin dhe nxënien e dijes është pikërisht në këtë pikë. Mistikët thonë se dija e vërtetë është dija për të Vërtetën, për Qenien, domethënë, dija hyjnore. Njeriu si krijesë e Zotit është bartës i dhuntive të Tij, dhe për pasojë tek ai është vatëruar fuqishëm dija hyjnore. Për shkak se subjekti i kësaj dijeje nuk është i ndarë prej objektit, ai që di dhe e ditura paraqiten njëkohësisht. Dija i është dhënë njeriut dhe pret që të largohen ato pengesa që e pengojnë paraqitjen e saj në dukshmërinë njerëzore.

Poezia mbi të vërtetën është melodia e të qenësishmes. Ashtu si Parkeri dhe Bethoveni në muzikë, te kjo poezi përjetohet ritmi dhe ledhatimi i paqhtë i gjithësisë. Ndërkohë, kjo nuk bazohet te soditja e dëgjuesve apo lexuesve të mundshëm, për shkak se është përplot me sensin e krijimit. Kjo poezi e heq në çast vëmendjen e arsyes nga çdo analizë mbi gjërat jashtë nesh, por edhe nga koha dhe hapësira; domethënë, nga lëndorja, dhe e përqendron vëmendjen vetëm te bërthama e të qenët, ose thelbi i ekzistencës. Kështu pra, kjo na jep mundësinë që të përqendrohemi tek e kulluara dhe te qenësia e zhveshur nga forma. Dihet që poezia, në veçanti ajo shpirtërore, është krejtësisht diçka tjetër nga shkrimet tjera. Poezia nuk mund të përkthehet në asnjë shprehje tjetër. Ajo përthith nga jeta harmoninë dhe qëllimin. Ja se si e ka treguar Fuzuli cakun e vërtetë të saj: "Me dëshirën për të arritur tek e vërteta, u nisa në rrugën e alegorisë dhe sqarova fshehtësitë. Gjoja jam duke rrëfyer ndonjë tregim. O Zot, nëpërmjet Lejlës nisa të shpjegoj cilësitë e Tua, ndërsa me gjuhën e Mexhnunit shpreha nevojën time ndaj



Teje, dhe kështu u luta pa pushim. O Zot! Lejla e sekretit të Realitetit u desh të shihej nga pas perdes së njëshmërisë; të zbukurojë gjithësinë lëndore me pasqyrimin e bukurisë, dhe shpirti i Mexhnunit, duke shëtitur nëpër shkretëtirë, të shohë këtë bukuri dhe të nënshtrojë vullnetin e tij përpara kësaj bukurie..."

Të shkruash poezi dhe për poezinë është ndër punët më të vështira. Poezia, në përgjithësi, është djersitje e shpirtit dhe, ngjashëm si të depërtosh në shpirtin e poetit dhe të parafrazosh ndjenjat e tij/saj të brendshme kur edhe vetë poezia nuk ka arritur t'i pasqyrojë sa duhet ato. Kjo bëhet edhe më e vështirë kur poeti nuk shkruan me vizore dhe vija të drejta, por ngjashëm si estetika e natyrës, i derdh ndjenjat në letër me vija të lakuara. Pra, poezia kur përpiqet ta parafrazojë Hakikatin/të vërtetën ka një karakter të tillë. Vargjet e poezive, në këtë kontekst, janë përplot me dashuri të thellë, mall, dhembje, brengë, por njëkohësisht edhe didaktike, pasi nga vetë kuptimi i tyre dalin mesazhet që janë pjesë e përvojës mbi të Vërtetën. Përvoja, si ajo lëndore po ashtu edhe ajo tej lëndore, mësohet vështirë, por ama nuk ka qartësi më të mirë për konceptin e zjarrit përpos djegies me të. Në letërsinë metafizike ka tre nivele të përjetimit të realitetit. I pari tregohet me simbolikën e ecjes në brigjet e detit dhe freskimin e këmbëve në ujën e detit. I dyti, me hyrjen në det dhe notimin në sipërfaqe të ujit, ndërsa i treti me zhytjen në thellësitë e detit dhe përjetimin e prekjes në rërën e lëmuar të sipërfaqes në fund të detit. Kështu është edhe poezia. Dikush e shkruan duke i lagur këmbët në bregun e të vërtetës, dikush qëndron mbi sipërfaqen e vargjeve, ndërsa dikush depërton thellë në ndjenjat dhe krahas asaj që shpesh mund të mbetet pa frymë ekzaltohet nga bukuria e thellësisë. Poezia e Haki-

katit/të vërtetës insiston të gllabërojë, të përpijë, të pushtojë hapësirën e pakapshme të ndjenjave dhe që është më e vështira, të njëjtën ta shndërronë në porosi, në mesazh për të vërtetën e aktualitetit apo edhe të mundësisë.

Vargjet e kësaj poezie deri në fund e shfrytëzojnë përmasën ndiesore për t'u emocionuar, për të vajtuar për (pa)dashurinë, për Zotin, për (jo)njeriun, për hiçin, për boshllëkun, për ngrohtësinë e rrezeve, për vendlindjen dhe kështu me rradhë. Poezia, në këtë rast, flet dhe na e tregon sekretin e dashurisë, edhe pse ne shumë herë nuk arrijmë ta gjejmë dhe ta piketojmë objektin apo subjektin e dashurisë. Kjo dashuri nuk ka kurrë një qëllim shfrytëzimi dhe nuk është e ngarkuar me të, vargjet dashurore nuk dëshirojnë të "pushtojnë" dikë, por dëshirojnë të "pushtohen". Vargjet e poezisë mbi të Vërtetën nuk janë mjet për ndonjë përpjekje praktike, madje as për dashuri lëndore. Me to, nuk mund të arrihet diçka, por me to mund të nisesh vetëm në një rrugë që përfundimisht do të arrihet gjithçka. Po kështu, poezia është një art elitar. Vizitohet nga një numër i vogël njerëzish, të gatshëm dhe të aftë për të jetuar, përveç shumicës që synojnë të mbijetojnë ose, kur rrethanat historike e lejojnë, të jetojnë sa më rehat.

Plotësia dhe kuptimi i këtij elitizmi të poezisë shfaqet mbase më qartë edhe në poezinë për dashurinë ndaj Zotit. Ajo është në vorbullën më të thellë të thelbit të jetës. Poezia e dashurisë mbi Zotin nuk shfaqet në një kohë kur synimi është të fitosh diçka sa më shpejt, por në një kohë kur janë edhe njëqind të tjerë në një lidhje dashurie. Nga të gjitha llojet e marrëdhënieve midis njerëzve, dashuria ndoshta hap çështjen e së mirës dhe së keqes, të bukurës dhe kalueshmërisë, lirisë dhe kufizimit, sublimitetit dhe banalitetit, të jetuarit

dhe të vdekurit. Oh, si do të ishte sikur poezia e dashurisë të ishte dashuri! Do të kursenim mundime të ndryshme, dhe do të kishte emocione të ndryshme në dashuri. Meqenëse nuk është kështu, na mbetet të imagjinojmë dhe pastaj t'i shprehim përmes vargjeve këta emocione dhe të shikojmë me bisht të syrit se si zbehet dashuria. Dhe pastaj, befas, e ndjejmë sagën e dashurisë: kaloi, por nuk u largua.

Ndër poezitë e shkruara për të Vërtetën ka edhe të tilla që flasin për relativitetin e hiçit. Këta vargje, sikur dëshirojnë të debatojnë me ne për (mos)ekzistencën e asgjësë. A ka asgjë nëse ka plotni, nëse ka Zot! Mesazhi është se asgjëja është hipotetike dhe pjellë e mendjes relative.

E vërteta, në poezinë e Hakikatit është simbol i jetës, përjetësisë, ngrohtësisë dhe dashurisë fituese, gjëja më e çmuar, e dashur. Sytë e poetëve përqendrohen te e Vërteta, sikur kërkojnë mbrojtje prej saj. Në këto poezi janë të përmbledhura shumë koncepte ekzistenciale. Aty është feneri (pishtari i dritës), zogjtë (këngëtarët e të përtejmes), foleja (prehëri i qenies), drita (pasqyra reflektuese e Njëshit), dëshmia (prova e ekzistencës), braktisja (largimi nga lakmitë), veza (nukleusi i jetës), mëshira (shfaqja e attributeve hyjnore), flaka (këndellja e hakikatit), e vjetra (tradita perreniale), tregimi (rrëfenja nga e përtejmes), dashuria (ashku), nana (pjellorësia, kujdesi, edukimi)...

Për fund të them se poezia në mënyrë shumëpërmasore dhe të shtresuar, racionale dhe mbiracionale, të shqiptuar në një figurë ose gjuhë bisedore që i jep gjuhës së poezisë fuqinë e shprehjes së porosisë, entuziazmin dhe ankthin nga të cilat lind nevoja për të tjerët, përpiqet ta formësojë, për ne, të Vërtetën.

HARRESA SI MALLKIM!

Fehmi AJVAZI

Nuk ka jetë të jetuar pa gjurmët dhe përvojat e saj! Dija, dhe para saj kujtesa, nëse nuk respektohen apo braktisen, nuk janë vetëm një koncept që e deformatojnë dhe e shterin mendjen, trupin dhe shpirtin, madje deri në thelb të metafizikës sonë, por është edhe diçka tjetër: harrimi – shemra zhbërës e kujtesës! Pra, e kundërta e “kujtesës”, harresa e përbën atë që Kundera e përkufizon s’i “humbja” e së shkuarës! Prandaj, “metafizika e njeriut”, është e njëjtë si në sferën private, ashtu edhe në atë publike. Gjykimi ynë individual dhe e drejta nuk parashkruhen nga elementet e forcës dhe krimi dhe as nuk duhet që ta lejojmë këtë, ashtu sikurse ato as nuk përfundojnë përballë një mëngjesi plotë dritë, apo përballë të madhërishtes me kurorë hyjnore! Jeta jonë më shumë është e rrëmujshtme, pakrahasimisht e lëndueshme, por edhe katandisur ama, ajo nuk duhet lënë në “tregun e plaçkave” apo në një lëndinë meraje! Duhet farkuar ajo minutë për minutë, hap pas hapi, qoftë edhe me sagën e sizifit. Por, nën këmbët tona ndodhet formula e prodhimit të lirisë së domosdoshme, pa të cilën thjeshtë nuk ekzistojmë!

Antiliria vjen kryesisht nga njeriu: s’i doktrinë e atij që e mohon, e dhuron dhe e pushton-sundon tjetrin, dhe s’i formë e përmbajtje e nënshtrimit tonë. Nuk e urrejë atë, lirinë as si “mungesë të robërisë”, dhe as si peng të “origjinës” së mugët, kontradiktore dhe ndoshta kaotike për shkak të “gjurnit me mullingjinë” ose, pse s’vinte guximi, mujshia natyrore dhe drita e humbur kushedi se kur n’heartland! Gjykimi se edhe një njeri i vetëm në shkretëtirë “ka të drejtë ta shohë një tjetër njeri nga lartë poshtë, vetëm kur e ndihmon të ngritët” (Markezi), mund të përligjet me një çast vetëmohimi, por ta kundrosh “dritën” në këmbim të “gjurnit” polar, do të thotë të mbetesh gjithmonë duke parë poshtë lart: pa arritur të mbetesh në këmbë, drejtë, vetëmohues, i lirë, zotëruar i jetës tënde...

Le të marrim temën – kategorinë tjetër: harresën! Ky është problem i madh privat i njeriut: vdekja si humbje e vetvetes! Por, çfarë është vetvetja? Shuma e gjithçkaje që ne mbajmë mend. Pra, ajo që na tmerron te vdekja nuk është humbja e së shkuarës. Të harrosh, është një formë vdekjeje përherë e pranishme në brendinë e jetës”, thotë Kundera. E cili është helmi i harresës? Shkrimi, padyshim shkrimi përmes kujtesës dhe aktualitetit në gjallim e sipër. Prandaj, shpresoj të mos më kundërshtoni edhe kur gjykoni se keni të drejtë në mënyrat që gjykoni, sepse, në fund të fundit, jeta është vetëm ajo që na kujtohet! Në këtë kontekst, sipas Kunderës kujtesa nuk është vetëm pjesë strukturore metafizike e jetës që kalojmë, por është edhe politike. Po, politike sidomos kur elementi psikofizik, harresa, instrumentalizohet në shkallë të organizuar dhe, mbi objektiva. Ja si e zbërthen Milan Kundera (shkrimtar) përmes një shembulli konkret mënyrën e imponuar të shtetit, në fakt metodologjinë e defaktorizimit nacional përmes ‘harresës’ nga ideologjia ekspansioniste komuniste dhe shteti komunist i Çekoslovakisë në kohën e tij:

“Të harrosh, është edhe problem i madh i politikës. Kur një fuqi e madhe do t’ia heqë një vendi të vogël ndërgjegjen kombëtare, ajo përdor harresën e organizuar. Pikërisht kjo po ndodh në Bohemi. Letërsia bashkëkohore çeke, deri në masën kur ka njëfarë vlerë, nuk është botuar për 12 vjet; 200 shkrimtarë çekë janë ndaluar, përfshirë edhe

Franc Kafkën që ka vdekur; 145 historianë çekë janë shkarkuar nga postet, historia është rishkruar, përmendoret janë shkatërruar. Një komb i cili humb vetëdijen për të shkruarën, dalëngadalë humb vetveten. Dhe kështu, gjendja politike ka ndriçuar brutalisht problemin e rëndomtë metafizik të harresës, me të cilin përballlemi gjithë kohës, dita-ditës, pa i kushtuar fare vëmendje. Politika i heq maskën metafizikave të jetës private; jeta private i heq maskën metafizikave të politikës.” (1980)

Në këtë kontekst, që të mos na rri deri në fund mendja e varfër, e plakur dhe inerte, t’mos na zhduket e kaluara, gjurmët, t’mos na fshihet e deformohet nga trupi ynë dhuntia e quajtur ‘mendje’, është plotësisht logjike që ne t’i vardisemi kujtesës, dijes dhe shkrimit. Kështu duhet të ngadhënjëjmë me çdo kusht ndaj harresës përmes mjeteve dhe teknikave të caktuara, ndërsa rrjedhat e jetës sonë le të jenë në vijimësi “piramidë” e gjurmëve tona! Sepse, gama universale e quajtur “jetë” nuk është rastësi, kurtuazi, imoralitet, manipulim me ne i ligjeve të natyrës apo i ligjeve metafizike – hyjnore. Gjithnjë, është e kundërta: humbja e së shkuarës, domethënë është “jetëshkrimi ynë” trashëgim – e madhërishtja e dhënë...!

Epo, unë nuk e kam gjithë mendjen vetëm te dija dhe kujtesa, te efektet, ndikimi etj., sepse këto janë gjithnjë çështje komplekse por, ne s’mund ta fajësojmë botën për mungesa të këtylla, mendjen e kam më shumë te natyra jonë neglizhente, te organizimi, te përkushtimi dhe te sfidat e tjera që, i kthejmë në norma jetësore! Markezi thotë se, “vdekja nuk vjen me moshën, por me harresën” prandaj, harresës, kësaj mortijeje shëmtuese e varfëruese duhet mbajtur mbyllë portat vazhdimisht...



Enver Visoka

NATA E PRERË ME GËRSHËR

si vdes mrekullia
e kësaj nate të prerë me gërshërë
braktisur nga frika për Zotin
anijen kthen, anijen mbyl...
mbyllur në atë furtunë
ngërthen majë qielli sytë
e Ti epshore ashtu lakuriq rri
derdh kaçurrelët e zinj mbi varg, mbi poezi
dalë nga ai zjarr si gjithherë bezdis
si një pëllumbeshë haralisur
majë drurit të qershisë

s’ ka gjë më të tmerrshme, më të ethshme
se të hysh dhe të dalësh gjallë nga ajo natë jete
ku s’ mund të vesh asnjë presë, asnjë pikë
përveçse nga ai zjarr përjetësie
të shohësh se si bukuria e asaj nate
po jep shpirt....

PEMA E MËKATIT

me dashurinë
drejt bëri hile
nenë pemën e mëkatit
ra një rrufe
pranë këmbëve
aty
Zoti ua fali jetën
jetën ua fali Zoti
dikush e preu atë pemë
dhe rrufetë e morën në qiell
në qiell përfundoi ai hark dashurie
i ngujuar në një yll
i ngujuar në një pyll
...

hija e tij shtrihet zvarrë
mbi savana e stepa, shkretëtira e oaza
o Zot i pafund është ky oqean
nuk i dilet dot andej
nga rrufetë, shtrëngatat
gjerësia dhe magjia të ngulfasin
të ngulfasin, o Zot
klithmat e sirenave
në tokën e dashurisë ato duan të shkelin
të shkelin o Zot në tokën e dashurisë,
sirenat...
nuk mundën të kthehen më
se ai që preu pemën e mëkatit
preu edhe këmbët e tyre

...
o Zot, ç’ janë këto klithma
që vijnë nga ai orkan
nga ai orkan që përfundon në qiell
në qiell përfundon edhe ky hark diellor
...
të goditur rrufesh
mbi pemën e mëkatit digjen këta shpirtira
o Zot!...

ANKTH

Trëndafil i zi mbytet në ujë
-këte s’ duhet t’ia thuash askujt

Pyll i verbër mbetet ngujuar
në gojë ujku duke uluruar

nën Lulepeshkën e tharë
plasim duke qarë

i thash, më gjej Lëkurën
e fshehur nën gurë
se nga kjo ëndërr e keqe

...çdo gjë tani është e braktisur
në oqeanin e bezdisur

po të gjeja atë lëkurë
në tokë s’do të kthehesha kurrë

farë e fis do t’ gjeja në oqean
do të ngrehja dolli për atë që jam...

Mbi profilin poetik të Irma Kurtit

VARG ME MUZIKALITET

Për autoren, poezia është sfidë ndaj së shëmtuarës dhe estetikë përsosmërie për të bukurën, është solemnitet mendimi dhe parajsa e fjalës



Agim BAJRAMI

Sa herë që lexoj emrin e Irma Kurtit, më kujtohen anketat e famshme muzikore te atyre viteve, kur shumë kompozitorë dhe poetë të talentuar, që s'kishin fat të prezantoheshin në festivalet kombëtare të RTSH-së së asaj kohe promovonin këngët e tyre të mrekullueshme në Radio - Tirana. Ishin këngë që në njëfarë mënyre binin ndesh me shijet e soc-realizmit, por që kishin një impakt të fortë të dëgjuesit dhe njohësit e mirë të muzikës. Pikërisht, në këto anketa dhe më pas në Festalet e këngës, unë jam njohur me vargun e mrekullueshëm të Irma Kurtit, varg me një aromë dhe brishtësi vajze plot me ëndrra dhe vizione. Dhe kur vargu shoqërohej nga muzika e mrekullueshme e kompozitorëve Ilir Dangëllia, Luan Zhegu si dhe zëri i këngëtarëve Ermira Babaliu, Kozma Dushi apo të tjerë, ai merrte përmasa gati magjike. Nëse do të më duhet te citoj një thënie të dëgjuar nga të tjerë, mund te them se Irma Kurti ka lindur së bashku me poezinë dhe e ka të vështirë identifikimin e emrit të saj pa të.

Poete me një natyrë te ndjeshme lirike, ajo vazhdon të shpërfaqë çdo ditë para nesh pjesët më të bukura te natyrës së saj shpirtërore dhe të arealit ku jeton. Ndonëse libri i saj i parë "Këtë natë me ty" u botua në vitin 1999, autorja ndërkaq e kishte shpërfaqur kredon e saj poetike, në një varg lirikash interesante botuar në të përjavshmet dhe periodiket e kohës. Në vëllimet pasuese deri te përmbledhja poetike "Ti je loti im", udha e saj krijuese jo vetëm ka njohur ngjijtje, por ka fituar shumë adhurues dhe lexues me kërkesa artistike. Nga libri në libër, harta e subjekteve dhe situatave poetike të saj është bërë më e gjerë dhe

më e larmishme. Një dukuri e tillë ka sjellë që zëri i saj autentik prej gruaje të tërheqë gjithnjë e më shumë vëmendjen e kritikës së specializuar, këtej dhe andej brigjeve të Adriatikut, pa harruar këtu përkthimet e ndryshme të librave të saj në disa vende të botës.

Të ndjeshme, të brishta dhe plot adrenalinë, poezitë e Irma Kurtit e kanë gjithmonë fillësën nga një prekje e momentit, nga një fabul rastësore, ose nga ngacmimet që lindin nga erërat nostalgjike të së kaluarës. Janë pikërisht këto lloj ngacmimesh që venë vazhdimisht në lëvizje mekanizmin e saj krijues, fantazinë e pasur dhe narracionin e ngrohtë që e karakterizon. Shumë nga poezitë e Irmës e konfigurjnë vetveten me fytyrën e ditës, që duhet të zbardhë, me imazhet e prindërve te vdekur ose me një mbrëmje të dehur nga dashuria. Është një larmi e tërë gjendjesh emocionale, ankthi dhe gëzimi, që autorja ka ditur t'i derdhë mjeshtërisht në kallëpet dhe format e tyre përkatëse. Nëse në librat e saj të parë, përshkrimi i jashtëm ishte në raporte të barasvlershme me atë të brendshmin, në librat e tjerë ky raport ka anuar gjithnjë e më shume nga ky i fundit, çka tregon për një prirje të autores drejt poezisë me karakter psikologjik dhe përsiatjes. Edhe pse prej një kohe shumë të gjatë, qëkur ajo e ka ndryshuar rezidencën dhe mjedisin e saj social, përsëri bërthama e saj krijuese ka mbetur e njëjtë si me parë. Varg me muzikalitet, me një fabul rreth të cilës sillet dhe organizohet mendimi poetik, detajet e imta artistike dhe elementi lirik. Janë poezi me një teksturë te pasur jetësore dhe filozofike. Në ciklet e poezive për atdheun, krahas tejdukshmërisë së mallit për të spikat shqetësimi dhe

dashuria e saj e madhe për njerëzit dhe vendet në të cilat autorja u rrit dhe u edukua, që janë kaq të lidhura me të shkuarën dhe të tashmen e saj. Mund të pohojmë pa ngurrar se në poezi të kësaj natyre aftësitë përshkuese dhe artistike të autores kanë kapur nivele të larta artistike. Në poezinë - rekuem, kushtuar të atit në orët e fundit të jetës kemi një zbërthim psikologjik të luftës mes jetës dhe vdekjes, të shpirtit që do të çlirohet dhe këmbënguljes së njeriut, për ta mbajtur sa të mundet atë brenda vetes. Janë përshkrime dramatike shkruar me një dorë që dridhet nga dhimbja, por që megjithatë, nuk karakterizohen nga fataliteti, siç ndodh rëndom tek të tjerët: Sekonda, minuta kalojnë/ora në mur, një kërcënim/që godet në perëndimin pa ngjyrë. Sonte, unë rri/afër shtratit tënd,/ ndërsa ti po largohesh përgjithnjë.

Të njëjtin ngjyrim emocional përftojmë edhe gjatë leximit të poezisë "Kush do të t' mbrojë": Kush do të të mbrojë ty nga ankthet/ kur unë të mos jem më në këtë botë, /kush do t'përkëdhelë ballin e bukur/ dhe të thotë: "Flemë, se u bë vonë?".

Në këtë krijim, ndonëse në pamje të parë ngjan si një dialog i zakonshëm sentimental mes një çifti, përroi ndjesor që vërshon nga këto fjalë të shqetësuara gruaje dhe të dashure është i aftë të përmbysë njëmijë brigje mosbesimi. Kjo sepse autorja di të operojë mjeshtërisht me thelbin e shprehjes së saj përbotëse dhe jo me anën tingëluese të saj. Për poeteshën poezia është sfidë ndaj së shëmtuarës dhe estetikë përsosmërie për të bukurën, është solemnitet mendimi dhe parajsa e fjalës. Prandaj në portat e vargjeve te saj hyjnë e dalin vazhdimisht njerëz simpatikë, vajza plot botë shpirtërore dhe gra të forta që dinë ta gdhendin


me forcë portretin e tyre në kohë dhe në hapësirë: Sa lot kam derdhur, sa shumë të tjerë/në qerpikë më ngrinë dhe sa herë/ jam rrekur veten ta gjej nën rrënoja /për t'u ngritur në këmbë më e paepur sërish.

Si çdo punëtoare e fjalës dhe vargut te bukur, autorja mundohet t'u japë atyre formën e mendimit dhe ideve që e preokupojnë atë. Ajo është e vetëdijshme se veshja e saj me figura dhe energji shpirtërore e bën më rezonuese. Këtu duhet përmendur edhe karakteri i theksuar bisedor i kësaj poezie, fryma intime mes folësit dhe dëgjuesit dhe anasjelltas. E thamë që në krye se "qershia mbi tortë" e krijimtarisë së kësaj autoreje mbetet lirika ndjesore. Është një lirikë që të shkakton rrahje të forta zemre që në leximin e parë dhe që të mbetet gjatë në kujtesë. Në këto lloj poezish heroina lirike tenton të shpërfillë me ngulm formatet dhe linjat më të cilën është vizatuar gjer më tash portreti i saj, të flakë ndrojtjen dhe të dalë me vendosmëri nga kornizat kufizuese ndaj saj. Si e tillë, ajo nuk e fsheh simpatinë dhe tërheqjen që ka nga e nesërmyja dhe modelet e rinj që pritet të sjellë ajo me vete. Lirikat e Irmës i shprehin hapur ngjyrimet entuziaste për dashurinë dhe botën e saj të madhe. Figurat e shumta që i shoqërojnë ato dhe gjurmët që lënë gjatë artikulumit janë kaq të dukshme dhe autentike. Edhe pse të shkruara në vetën e parë, kuptohet vetiu që ato janë larg personalizimeve vetjake, por për çdo njeri që dëshiron ta gjejë veten aty. Përdorimi i vetës së parë në to është thjesht një intrigë artistike: Një dimër i gjatë të dyve na pret/ brenda katër mureve të një shtëpie /që më nuk na nje, brenda një jete/ që nuk na përket, unë këtu e ti atje.

Mjaftojnë vetëm këto katër vargje për të parë se ç'dhembje dhe ç'boshllëk ngjall mungesa në shpirtin dhe trupin e dy njerëzve që duhen, por që jetojnë larg njeri - tjetrit. Është një dhembje që sundon gjithë qiellin e kësaj poezie dhe e bën lexuesin të drithërohet. Duke lexuar ciklet e poezive të Irma Kurtit të botuara në gazeta e revista të ndryshme letrare, nga më të mirat në krijimtarinë e saj, lexuesi ka rastin të njihet me botën e brendshme shpirtërore të autores, me ndjesitë dhe konceptet e saj për dashurinë dhe shenjtërinë e saj, shoqëruar me pamjet dhe portretet përkatëse. Jo më kot, ato kanë marrë vlerësimet më të larta nga juritë e ndryshme ndërkombëtare. Simbolikat e gjetura dhe metaforat janë shoqëruese te pandashme gjatë gjithë udhëtimit në viset e leximit të këtyre librave. Poezisë së Irmës i pëlqen të bashkëbisedojë me objektin e saj poetik, pa marrë parasysh nëse është njeri apo send. Nëse objekti poetik është njeri, ajo e vesh me frymë dhe i pëshpërit në vesh fjalë pranverore, nëse është send, ajo i afron diçka nga shpirti i saj, duke e nxjerrë atë nga gjendja e tij e ngurtësuar. Është e qartë që në këtë rast nuk kemi të bëjmë me trille alkimistesh, as me fantazi të përçartur, por me një poete, që kjo botë ka nisur t'i duket e ngushtë.

DASHURI ME SHIKIM TE PARE

Më është bërë fiksim, kam ruajtur në mendjen time që transformohet dhe mbushe-zbrazët vazhdimisht, ikonën time të parë të Heminguejt. Kërrusur mbi një makinë shkrimi. Kam bërë edhe një vjershë për këtë, por shumë më vonë, kur shprehesh nëpërmjet tyre



Grigor JOVANI

Ernest Heminguej, shkrimtari absolut, një farë perëndie. Për mua, natyrisht, të tjerët mund të kenë mendje të ndryshme. E kam adhruar qysh fëmijë. Përpara se të dashuroja. Dashuria ime e parë ishte shkrimi. Nuk dua të them se në vazhdim u bëra shkrimtar si ai, por dashuria ndodh, e para me shikim të parë.

Më është bërë fiksim, kam ruajtur në mendjen time që transformohet dhe mbushe-zbrazët vazhdimisht, ikonën time të parë të Heminguejt. Kërrusur mbi një makinë shkrimi. Kam bërë edhe një vjershë për këtë, por shumë më vonë, kur shprehesh nëpërmjet tyre. Qysh atëherë, fëmijë, m'u mbush mendja se nuk mund të bëhesh shkrimtar, pa pasur dhe pa shkruar në makinë shkrimi. Kisha dëgjuar që edhe librat e tua duhej t'i dërgoje të shaptilografuara për botim. Në gjimnaz, kur fillova të shkruaj më seriozisht, më pak, por dhe të botoja, mendova se ishte koha të kisha edhe unë... armën time. I kërkova xhaxhait në Athinë të më dërgonte një makinë shkrimi. Ishte avokat dhe duhej të kishte ndonjë të tepërt.

"Ç'e do?" pyeti ai tim atë, shoferin, në telefon.

"Ku di unë, shkruan ca budallallëqe! Mos ia ço, se do na fusë brenda!"

Xhaxhai ma dërgoi, por nuk ma dhanë në doganë. Nuk lejohej. Mund të bëja me të propagandë.

"Dua të shkruaj me të vjershat e mia!" protestova.

"Pse, humbën nga dyqanet lapsat dhe fletoret?" më pyetën injorantët, tërë inat dhe dyshim.

"Ikim! - më tërhoqi im atë. - Thashë unë, do të na bësh gjëmën ti!"

Dola nga ajo doganë, si qen i rrahur. I yni, Loni në fshat, kur i gjuante im atë me shqelm, i kthehej hakërueshëm, biles tundte kërcënueshëm edhe bishtin. Unë nuk bëja nga këto, im atë ishte më i rreptë me mua, se me Lonin. Më tregonte vëndin.

Vite më vonë, kur mbarova filologjikun dhe isha bërë edhe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve, mendova se më takonte tashmë një makinë. Por, ngaqë e kisha shkelur një herë, mendova të pyesja më parë. Kur u gjenda një herë në fshat, u hodha përsëri me tim atë gjer në Kakavijë. Pyeta në doganë.

"Ç'e do?"

"Shkruaj".

"Ku punon?"

"Mësues, në malësitë e Mirditës".

"Ku në Mirditë?" - u interesua gjallërisht doganieri polic, që nga dialekti duhej të ishte nga ato anë.

"Në Repts".

"Aha, afër Shpalit, minierës, - tha ai dhe unë kuptova se nënkuptonte edhe burgun. - Gjej ndonjë kuadër jabanxhi atje, ka shumë, të t'i shtypi këngët në zyrën ku punon. Makinat nuk lejohen për privatët. Të ishte gazetar... rregullohej, me ca vërtetime. Ndryshe, më vjen keq..."

"Ikim! - më tërhoqi prapë im atë, si vite më parë. - Thashë unë, do të na çosh pas hekurave ti".

Dolëm nga dogana. Turfulloja. Tani nuk kisha frikën e dikurshme nga im atë, mos më sillej ashpër se Lonit. Ishte zbutur shumë, sa edhe Loni vetë e kishte kuptuar. Nuk i hakërrehej më, duke i tundur kërcënueshëm bishtin. Me dy çunat e tij, mua dhe Lonin, babai tani sillej më butë. I kishim dalë nga duart.

Ja që e solli rasti edhe fatin tim. Pas një viti u bëra gazetar. Pa i thënë fare tim eti, i shkrova xhaxhait. Kërkesa ishte e njejtë, një makinë shkrimi. Për ta bindur, me shaka, i bashkëngjita letres një fotografi. Të Heminguejt mbi makinën e shkrimit. Çuditërisht, kjo ide e fundit, bëri efekt më tepër se kërkesa ime e përsëritur. Xhaxhai ishte i majtë, komunist me xhep kapitalisti, domethënë.

"E kuptova, dëshiron t'i ngjasësh Heminguejt. Je në rrugë të drejtë. Edhe ai, mik me Kastron është, në Kubë jeton, është si ne. Po ta dërgoj, po shiko se mos na e hanë. Të parën nuk ma kthyen pas..."

Tani nuk mund të na e hanin. Isha bërë pjesë e tyre, në nomenklaturë. Bëja propagandë socialiste, domethënë. Mora autorizimet e duhura dhe drejt e në doganën e Kakavijës. Pasi më kishte lajmëruar xhaxhai nga Athina, se e kishte dërguar.

I njejtë ritual.

"Ç'e do?"

"Të gatuj!" u përgjigja unë, me dëshirën hakmarrëse të shlyerjes sadopak të borxheve të mëparshme.

"Shiko, nuk bëjmë lojëra këtu!" m'u hakëros polici doganier dhe sytë i vajtën qëllimisht tek hekurat që kishte hedhur në një karrige pranë, për të më dhënë mesazhin e duhur.

Më kishte ardhur në shteg. Nuk kisha edhe tim atë pranë kësaj here, të më tërhoqte jashtë. Më priste tek kafeneja në fshat, bashkë me Lonin.

"Në është të të fusin në burg, shko vetë, - më tha, - ja, unë kam Lonin..."

"Po ç't'ju them! - iu ktheva edhe unë me inat doganierit. - Shikoni letrat një herë. Për këtë punë jeni këtu. Jam gazetar, makina e shkrimit më duhet për punë. Kam sjellë edhe autorizimet e duhura nga redaksia ime dhe Komiteti i Partisë i rrethit. Ja edhe Dëshmia ime e Gazetarit..."

Menjëherë, doganieri u bë tjetër njeri. U zverdh, u ngrit automatikisht në këmbë dhe më zgjati dorën.

"Oh, më falni, shoku gazetar! U keqkuptuam, kaq ngarkesë pune, e kuptoni, humbasim mendjen. Uluni, ju lutem, sa të bëj gati formularët. Është nder për ne, nuk na vinë përditë gazetarë..."

Kishte të drejtë ungji im në Athinë, nuk ishte keq t'i ngjaje Heminguejt, atij të Kubës që ishte mik me Fidelin, të silleshin mirë të kuqtë. Aq më tepër, kur bëje edhe punën e tyre.

Kanë kaluar kaq vjet qysh atëherë. Ndërrova pastaj disa makina shkrimi, ishte hobi im. Kur erdha në Athinë, u modernizova disi, mora makinë elektronike. Pastaj kompjuterët, që modernizoheshin herë pas here, si celularët dhe duhej t'i ndërroje, të përshtateshe me kohën. Veçse në mendjen time ka mbetur ajo makinë shkrimi e Heminguejt. Kur u njoha me të nëpërmjet fotografisë, gjatë fëmijërisë së largët. Dhe e adhurova me shikim të parë. Atëherë, kur nuk kisha dashuruar akoma...

MOIKOM ZEÇO DHE "STINA E BALONAVE"

Te vepra "Stina e balonave" shfaqen kundrime poetike të një përvoje me zë fëmijërie, që e prezantuan poetin të talentuar edhe në fushën e letërsisë për fëmijë. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 40-vjet, ato mbeten të freskëta, të magjishme edhe sot



Xhaid BUSHATI

Moikom Zeqo ishte 30-vjeç, kur botoi librin e parë poetik për fëmijë "Stina e balonave". Pastaj, një herë në dy vjet, e nga një herë vit pas viti, me të njëjtën Shtëpi Botuese që ishte e vetmja para viteve '90, siç ishte ajo "Naim Frashëri"; poeti Zeqo, botoi më pas: "Festa e Abetares" (poezi, Tiranë, 1981), "Skulptori i dëborës" (poezi, Tiranë, 1983), "Det, o det" (poezi, Tiranë, 1984), "Shtëpiza e pëllumbave" (poezi, Tiranë, 1986), "Çudia e fluturimit" (poezi, Tiranë, 1987), "Syri" (poezi, Tiranë, 1988), "Legjenda e Epidamnit" (poemë, Tiranë, 1989), "Tri shkronjat e hënës" (poezi, Tiranë, 1990). Viti 1990 shënon, mbase, mbylljen e kapitullit poetik prej nëntë librash. Edhe gjatë këtyre viteve e në vazhdim, krahas debutimeve në poezisë për të rritur, monografive, studimeve, eseve, analizave, sinopseve, skicave dhe prozës, etj., etj.; Moikom i kushton një vëmendje të veçantë edhe prozës për fëmijë. Te kjo prozë, me nota poetike, Zeqo lëvront guximshëm dhe sjellë motive shpesh të panjohura për letërsinë e fëmijëve nëpërmjet skicës, tregimit, rrëfenjës dhe përrallës, etj. Diapazoni tematik merr përmasa jo të zakonshme. Memoaristika kapërcen vitet dhe

shekujt e bëhet bashkëkohore. Miti dhe mitikja shfaqen kujdesshëm në subjektet e ofruara. Deti dhe "qytetet" nënujore me florën, faunën dhe misteret e saj plotësojnë me motive më tej portretin shumëformësh të krijuesit Zeqo. Mrekullitë dhe jashtëzakonshmja e botës përrallore përbëjnë stilin e Zeqos. Prirja drejt librave enciklopedikë e bëjnë shkrimtarin Moikom Zeqo model të një poliedriciteti dituror.

Te vepra "Stina e balonave" shfaqen kundrime poetike të një përvoje me zë fëmijërie, që e prezantuan poetin të talentuar edhe në fushën e letërsisë për fëmijë. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 40-vjet, ato mbeten të freskëta, të magjishme edhe sot. Duke folur për atë fillësë poetike, me të drejtë shkrimtari dhe studiuesi Odhise K. Grillo në një shkrim të tij thoshte: "... autori i ka hyrë me të gjitha forcat letërsisë për fëmijë dhe nuk kemi të bëjmë këtu me një rast të veçuar frymëzimi. ... Origjinalitetin e poetit Moikom Zeqo e shohim edhe në një drejtim tjetër. Ai nuk ndërton vjersha të përgjithshme..., por krijon një fabul sado të vogël... vjersha të këtij vëllimi kanë fabula domethënëse, të thjeshta e të kapshme, jetësore, që vogëlushët nuk i kanë lexuar tjetër herë."

Edhe pse erdhi nga letërsia për të rritur, poezitë për fëmijë të këtij vëllimi qenë një befasim i këndshëm, plot vlera për letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj. Hyri menjëherë në zemrat e fëmijëve. Rrezatonin krijimet e tij në mendim, ndjenjë e figurë. Qe një përveçesi dhe risi në raport me botimet poetike të asaj kohe, të cilat kishin një moralistikë të tepruar e të shfaqshme hapur, plot shtampa e pa vlera artistike. Kështu, në vitet '80, poeti i talentuar Moikom Zeqo, në procesin e tij krijues, i shtoi individualitetit të tij artistik edhe këtë faqe poetike, me botimin e librit "Stina e balonave". Një faqe poetike, ku gëlonin: tema të patrajtuara e këndvështrime të reja, figuracione të pasura, sintaksa poetike me udhëtime metaforash, fantazi të ndezura që të rrëmbenin e të ftonin drejt kozmosit të ëndrrave, detaje magjepsëse me plot të papritura, etj., etj. Të gjitha këto "pushonin" në mbretërinë e motiveve të detit që ishin dhe mbeten edhe sot të shtrenjta për individualitetin e poetit Zeqo. Teksa afirmohej si poet interesant me plot imazhe metaforike në poezinë për të rritur, në poezinë shqipe për fëmijë e të rinj erdhi si një stinë lodëtare e ëndërrimtare balonash. Erdhi me këtë magji stine pranvere, me

vrapin e shkujdesur të fëmijërisë së poetit përmes valëve të detit durrsak. Por, ama, erdhi "të përkëdhelë" edhe fëmijërinë e lexuesit, me motivet e librit "Stina e balonave"; e pse jo edhe të zbukurojë fëmijërinë dhe rininë time, si dhe rrugën time poetike që kisha zgjedhur si krijues.

Librat poetikë e librat në prozë për fëmijë të Moikomit të botuar deri më tani, si dhe përshtypjet, konsideratat, esetë... etj., etj., ndaj procesit letrar e zhvillimor të kësaj letërsie nëpër vite dhe dekada; mendoj që krijuesit Moikom Zeqo i japin dimensionin e figurës së dijetarit; dimension që është i rrallë në këtë hapësirë letërsie. Janë të njohura për mua, por të panjohura për kritikën letrare, e cila nuk e tha fjalën si duhet dhe mbeti në kufijtë e recensionit, për krijimtarinë për fëmijë të Moikomit, Janë të njohura për mua, por të panjohura për kritikën letrare, e cila nuk e tha fjalën (ende dhe sot) për vlerat që mbartin pasthënia (Në vend të pasthënies) te libri "Princi i Vjeshtës" (përralla, tregime dhe skica, Toena, Tiranë, 1995); pasfjala te libri "Tre libra në një" (Vetëm për fëmijë 100 vjeç dhe pleq 10 vjeç, Sh. B. Florimont, Tiranë, 2002), paraafjala e pasfjala te libri "Enigma E. Y. dhe Kalorësit Dardanë" (Tregime për pleq 10 vjeç dhe fëmijë 100 vjeç, Sh. B. Erik, botimi i parë, Tiranë, 2012), si dhe pasfjala te libri "Aventurat e fundit të Gishtos" (përralla) të autorit Frederik Rreshpja. Këto shënime autori Zeqo i ka hedhur kohë pas kohe. Këto shënime, që në të shumtën e rasteve dalin jashtë kufijve të librave autorialë, edhe pse janë bashkudhëtare me disa libra të tij, ata janë traktate filozofiko-eseistike e artistike në shërbim të rritjes së mëtejshme të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, në përgjigje të pyetjeve, si: -Ç'do të thotë të shkruash për fëmijë?, -Pse është e vështirë kjo letërsi?, -Si duhet duhet te jetë ajo në raport me shkrimtarin, me kohën dhe universin fëmijëror, etj.

Moikom, duke qenë nga natyra poetik dhe konciz, domethënëse dhe pasionant, filolog dhe kulturolog; këshillat dhe sentencat e tij, etj., janë thelbi i misionit fisnik të shkrimtarëve që kanë vendosur të shkruajnë për fëmijë e të rinj, se ç'detyra i presin ata për të shkruar vepra të jetueshme. Vjershat, proza, filozofia e shprehur e Moikomit në intervista, shkrime të ndryshme në shtyp, parathënie e pasthënie të shkruara për librat e vet dhe të tjerëve; janë një pasuri e vlefshme, aktuale edhe sot, shëmbëlltira dhe modele për t'i dhënë hove Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj që ende e ka zërin e vogël.

(Shkodër, prill 2023)

NJË EPOKË TË NDËRMJETME

Them se jam bir i një epoke të ndërmjetme, kur kishin shumë rëndësi ilustrimet me ngjyra që shoqëronin fëmijërinë në librat, revista fëmijërore, si edhe në lodrat


Italo CALVINO

Është një pedagogji që mund të ushtrohet vetëm mbi vetveten, me mënyra të krijuara hap pas hapi dhe me rezultate të paparashikueshme. Përvoja e formimit tim të parë është tashmë ajo e një birit të "qytetërimit të imazheve", edhe pse ky ishte atëherë vetëm në fillimet e tij, larg inflacionit të sotëm. Them se jam bir i një epoke të ndërmjetme, kur kishin shumë rëndësi ilustrimet me ngjyra që shoqëronin fëmijërinë në librat, revista fëmijërore, si edhe në lodrat. Besoj se fakti që linda në atë periudhë, ka ndikuar tej mase në formimin tim. Bota ime imagjinare u ndikua, në radhë të parë, nga figurat e "Korrierit të të vegjëlve", asokohe revista më e përhapur italiane për fëmijë. Flas për një pjesë të jetës sime që shkon nga tre deri në trembëdhjetë vjeç, para se pasioni për kinemanë të më pushtonte absolutisht, gjatë gjithë adoleshencës sime. Madje, mendoj se periudha vendimtare ka qenë ajo nga tre deri në gjashtë vjeç, para se të mësoja të lexoja. Në vitet njëzetë "Korrieri i të vegjëlve" botonte në Itali tregimet vizatimore amerikane më të njohura të kohës: Happy Hooligan, The Katzenjammer Kids, Feliz the Cat, Maggie and Jiggs, të gjitha të pagëzuara me emra italianë. Ishin edhe seritë italiane, disa me cilësi shumë të mirë nga shija grafike dhe stili i epokës. Në atë kohë, në Itali sistemi i tullumbaceve me frazat e dialogut nuk kishte hyrë ende në përdorim (filloi në vitet tridhjetë, kur u importua Mickey Mouse); "Korrieri i të vegjëlve" i rivizatonte filmat vizatimorë amerikanë pa tullumbacet, të cilat zëvendësoheshin me tri ose katër vargje me rimë poshtë. Sidoqoftë, unë që nuk dija të lexoja, mund të bëja fare mirë edhe pa fjalët, sepse më mjaftonin figurat. Jetoja me këtë revistë, që nëna ime kishte filluar ta blinte dhe ta koleksiononte që para lindjes sime, duke i lidhur numrat sipas viteve. Kaloja orë të tëra duke parë filmat e çdo serie nga njëri numër në tjetrin, tregoja me mend historitë duke i interpretuar skenat në mënyra të ndryshme, prodhoja variante, i shkruaja episodet e veçanta në një histori më të gjerë, zbuloja, veçoja dhe pastaj lidhja gjërat e përbashkëta të çdo serie, përzieja një seri me një tjetër, imagjinoja seri të reja, në të cilat personazhe dytësore bëheshin protagonistë.

Kur mësova të lexoja, përfitimi që shumë i paktë: ato vargje thjeshtuese me rimë të puthur nuk jepnin informacion sgarues; më shpesh ishin interpretime të historisë të bëra sipas mendjes së vargëzuesit, tamam si ato të mia; dukej qartë se ai nuk ia kishte idenë e asaj që mund të ishte shkruar në tullumbacet e origjinalit, sepse nuk kuptonte anglishten, ose sepse punonte mbi figura të rivizatuara e boshe, të bëra me mece. Sidoqoftë, i injoroja radhët e shkruara dhe vazhdoja në punën time, që më pëlqente shumë. Pra, të endja fantazi brenda figurave dhe në vazhdimësinë e tyre. Ky zakon, sigurisht, solli një vonesë në aftësinë time për t'u përqendruar në fjalën e shkruar (vëmendjen e duhur për leximin e fitova vetëm më vonë dhe me mundim), por leximi i figurave pa fjalë ishte për mua me të vërtetë një shkollë fabulizimi, stilizimi, krijimi imazhesh. Për shembull, eleganca grafike e Sullivanit kur jepte në sfond, në një figurë të vogël katrore, hijen e zezë të Felix the Cat në një rrugë që humbet në peizazhin prapa një hëne të plotë në qiellin e zi, mendoj se ka mbetur për mua model. Ajo çka bëra në moshë të pjekur, nxjerrja e historive nga rendi i njëpasnjëshëm i figurave misterioze të tarokut (lojë bixhozi), duke e interpretuar të njëjtën figurë çdo herë në një mënyrë të ndryshme, sigurisht që i ka rrënjët në atë përçartje fëmijërore mbi faqe plot me figura. Është njëfarë ikonologjie fantastike që kam provuar të "Kështjella e kryqëzimit të fateve", jo vetëm me këtë tip letrash, por edhe me tablotë e pikturës së madhe. Në fakt, jam përpjekur të interpretoj figurat e Carpaccios në San Giorgio degli Schiavoni në Venecia, duke ndjekur ciklet e San Giorgios dhe të San Gerolamos si të ishin një histori e vetme, jeta e një njeriu

të vetëm, dhe të identifikoja jetën time me atë të Giordio-Gerolamos. Kjo ikonologji fantastike u bë mënyra ime e zakonshme për të shprehur pasionin tim për pikturën: bëra timen metodën e tregimit të historive të mia, duke u nisur nga kuadro të famshme të historisë së artit, ose së paku nga figura që ushtrojnë mbi mua njëfarë sugjestion.

Le të themi se elemente të ndryshme bashkëveprojnë për të formuar pjesën e dukshme të imagjinatës letrare: vëzhgimi i drejtpërdrejtë i botës reale, shpërftyrim mes shajnish dhe ëndrrash, bota e figurshme e përçar në nivelet e saj të ndryshme dhe një proces abstraksioni, kondensimi dhe shpirtëzimi i përvojës ndjesore, me rëndësi të madhe si në vizatimin, ashtu edhe në verbalizimin e mendimit. Të gjitha këto elemente që, në njëfarë mase, janë të pranishëm në autorët që unë i shoh si modele, sidomos në kohëra shumë të favorshme për imagjinatën pamore, në letërsinë e Rilindjes, të Barokut dhe në ato të Romantizmit. Në një antologji timen të tregimit fantastik në shekullin XIX, kam ndjekur frymëzimin vegimtar dhe të bujshëm, që buron me shumicë nga tregimet e Hoffmannit, Chamissos, Arnimit, Eichendorfit, Potockit, Gogolit, Nervalit, Gautierit, Hawthornes, Poes, Dickensit, Turgenievit, Leskovit dhe arrin deri te Stivensoni, të Kiplingu, te Wellsi. Dhe, paralelisht me këtë frymë, kam ndjekur edhe një tjetër, madje ndonjëherë te të njëjtët autorë, frymë që bën që fantastikja të lindë nga e përditshmja, një fantastike e shpirtëzuar, mendore, e padukshme, e cila do të arrinte majat e saj te Henry James.



David CAPPELLA

GOBBO FLET PËR DASHURINË E FUNDIT TË JETËS SË TIJ

E doja, ajo mbeti mospërfillëse. Ajo rrinte ulur dhe i ngacmonte fëmijët e saj teksa luanin te këmbët e saj, indiferente ndaj ofsharjeve të mia. Aroma nga buqetat e luleve të freskëta ia tërhoqi vëmendjen më shumë se prania ime. Rrija në heshtje, duke studiuar fytyrën e saj. Ajo kurrë nuk e dëgjoi muzikën time pasionante – simfoninë e zjarrtë të zemrës sime. Unë dua, ama mua nuk më duan në këmbim. Dashuria pa dashuri që kthehet, nëse mbizotëron, mbizotëron përmes artit – artit tim. Një poezi e qetë që e pata shkruar më çliroi nga dashuria ime ndaj saj, e lëshoi një buzëqeshje në mua drejt vegullisë së saj. Ajo ishte fantazmë; e fantazmat nuk duan.

GOBBO PËR VDEJHEN E VËLLAIT TË TIJ DHE SAKRAMENIN E SHENJTË

Luigi i devotshëm ka vdekur. Dhimbja depërtoi në çdo organ të trupit tim. Humbja e vëllait tim më dobësoi, duke infektuar lotët e mi. U bëra kufomë që ecën, i sëmure, në dhimbje, zbrazëtia m'i shkatërroi nervat. Pavarësisht se a iu përmbajta sakramentit, apo nëse e kam gënjyer atin... Motivet tona shpalosen si ritualet, dhe ritualet lulëzojnë thellë brenda bijve të pabesë, që refuzojnë kalueshmërinë e tyre të përmjaltur. Pikëllimi im nxiti urrejtje të Firencës. U ankova, u ankova. U tërhoqa, ndieja keqardhje të thellë ndaj vetvetes, lutesha të vdisja. Morbiditeti më përqafoi. Unë ndalova së shkruari.

Pëktheu: Fadil Bajraj

SA SHPEJT

Sa shpejt u tret veli i kaltër
 në kohën që na shtang
 në skelete numrash matës
 që s'i lexon dot një fëmijë
 Dinim aq pak për më vonë...
 Më kujtohet si lëkundeshe
 në siluetën tënde buzë rrugës
 pastaj gishtat si dhimbje mbi xham
 dhe një pafundësi e mjegullt
 që ende më rrëshqet në tru si plazmë...
 Oh, ç'nuk do të jepja
 për atë mall që pikonte
 në pasditen e vakët mbi peron

MBËRRITI PËRSËRI VERA

Mbërriti përsëri vera
 me diellin e lartë si një kolonë therëse
 U fundos edhe më
 imazhi yt përftuar ngutshëm
 në vende të humbura
 Atëherë ranë në prehje gjymtyrët
 të nxehtë nga lëvizja
 gjer në mesnatën e brigjeve
 dhe të bulkthave
 U ftohën ngadalë
 nën gjethet e ngrira kujtese...
 Kështu të kam humbur
 si një zbehje
 e frutave të panjohura
 që ranë në tokë
 pa i parë një sy
 Tani ndiej edhe një herë verën
 me rërën e pafund në trup

KOHA VAZHDON TË SHKOJË

Pamjet zbehen
 nëpër kohën që shkon mbi gjithçka
 dhe s'mund të kujtoj më
 fytyrën tënde, gjymtyrët, të qeshurën
 Vetëm jehona janë zërat
 dhe imazhe për të ringjallur
 gjithë ç'që e shkuar...
 Është një betejë
 midis gjithçkaje që kam
 dhe bindjes se mrekullia kaloi
 Pa praninë e askujt
 koha vazhdon të shkojë
 dhe pa nëntekste
 Nëpër terrin tim të arsyeshëm
 baresin kujtime të kristalta
 me trajta iluzore e zëra
 që vetëm dikur i pata
 Prania mërgon pafundësisht
 nëpër territore të reja
 ku shirat shtypin ditët
 dhe mesazhet deshifrohen
 pa dritë natyrale, nëpër dhoma të ftohta
 Ajri mbush vendet bosh të mungesave
 dhe stinët shkojnë mbi qenie
 pa rëndësinë e moshës
 dhe zbehjen e trupave
 humbur pafundësisht në të shkuarën

KUSHTIMI

Për ty gjithmonë do të qaj
 përbrenda
 me togfjalësja të gjymtë vajtojcash
 që endin në ajër thirrje fëmijësh
 që kurrë s'do të jenë bashkë
 ashtu si ti dhe vetvetja
 kurrë s'ishit
 dhe katastrofat
 s'kanë për të qenë më klithma
 por çati të brejtura
 ku mjegulla kullon
 për në sytë e tu pendestarë
 Ditët do të shurdhohen
 në atë prag të vjetruar
 nga një palë hapa të vdekshëm
 Kurrë më s'do të të shohim
 dhe funerali yt
 do të jetë vetëm një lajm
 si kjo histori
 nisur befas
 mes mungesës dhe hijes së fajit

ILUZIONI

Si një ushtar i gjymtuar
 po kthehem, në këto vise të heshtura
 ku fluturimthi qeshë nisur
 Skeleti im tani fundoset
 i paqartë, nëpër delire heronjsh
 që kurrë s'patën rrojtur
 Dhe e di
 shumë vise kanë humbur
 nëpër trokun e flashkët të kandrrave
 ndërsa njerëzit binin
 duke mos dyshuar për ngjitjen
 E tmerrshme ish
 stuhia e verbër e fatit
 Si një dorë e lodhur ata ranë
 në rërën e verdhë të hiçit
 dhe u prehën
 pa pranuar asgjë nga rrethanat
 Në këtë stinë qeshë zgjuar
 mes mizërisë së tyre
 kur s'kishte më kohë
 për paqen e mbrame

HIMNET E NJË MIKU TË PASTËR

Kur përjetë i mbyllin sytë e vet
poetët ua hapin të tjerëve
Saadiu

Zot, pse më dhe fuqi ta shoh të ardhmen time të afërt?
T'i dorëzohem prajshëm dorës Tënde që më ndjek?

Në lum endacaku, me syrin e shpirtit të vet, sheh
çka fsheh mburoja e gjoksit tim – siç e sheh shqiponja e etur
Burimin e kthjellët nën koren e tokës.
Ime motër me fustanin e gjatë plotë lule
Të cilën dikur e mbanin veshur Babilonaset përgjatë lutjeve dhe shëtitjeve
Para pushtetit të Mordukut!
Më kërkoi me shikim dhe m'u afrua qetë.

Sapo nga ajo fytyrë hoqi perçen e hollë
Në sytë e saj lexova se ia kanë burgosur djalin!
(Atë që e heshtim, zbulohet vetë.)
E përmendi emrin Tënd dhe, sakaq, iku e frikësuar.

A ngeli ndonjë në Babiloni që nuk të dëboi nga kujtesa e vet
që nuk u mbështet në Ty?!

Kërkoi një dirhem – t'i blejë
Ushtarët e Mardukut
Në zemrat e të cilëve nuk prek dhembja e huaj.

Në dorë ia lëshova dhjetë dirhemë, të gjitha që i pata –
Veshur me një fustan të gjatë plotë lule
Psherëtinte për nënën e vet!

Netëve, derisa e ndjejë dorën Tënde të ngrohtë mbi kokën time,
Atë dorë që rri para heshtave të tyre,
E dija që po ma kthen dashurinë që ta pata falur
atëherë në rrugë derisa ia lëshova në dorë dirhemët një motre
të dëshpëruar
që ushqente kujtimin për Ty
derisa fëmija i saj kalbej nën pranga.

Sara ngrihet herët me një trup të freskët dhe të shenjtë dhe
Sërish shtrihet duke pëshpëritur
Sara përshëndet diellin, dielli përshëndet Sarën
Sara e lëshon kopenë zhurmojnë barinjte
Sara i puthë në flokë barinjte
Sara në mëngjes i lau flokët dhe ua fali aromën e vet
Sara mbledh thupra lishash i shkund gjethet e thata
Sara gjithnjë qanë sa herë që braktiset nga dielli, ndjenë tek fundoset
Bashkë me mallin në humnerë

Sara e pluhurosur nga bagëtia, ulur në një gurë,
Me një llambë të ndezur,
Takon bariun të cilit në mëngjes ia puthi flokun
Sërish e puthë
Sara ulë sytë para secilit
Sara i sheh të gjithë përveç atë i cili i shkon prapa
I thurur në mendimet e saj

O, ajo nuk e sheh atë që i fali edhe zemrën edhe mendjen,
Kopshtet shtëpinë hapësirën... gjithçka –
Përveç eshtrave, boshtit kurrizor, unazat që nuk mundi t'ia japë
E që ajo i pret çdo mëngjes derisa e përshëndet diellin dhe
Derisa ia puth flokët bariut!

Në atë kodër, në spitalin e tuberkulozit, në dhomën ku depërtojnë degët e
mollës
Duke dëshmuar për të vërtetën mbi jetën, varur mbi dritare
duke murmuritur drithërueshëm, mbi fytyrën tënde, mbi sytë e ëmbël,
mbi ballin tënd të ftohtë, mbi duart që kanë mikluar... ike, vetë,
me petalet gjysëm të mbyllur u zhyte drejt humnerës
me fytyrë të qeshur mban arkivolin ku më kanë futur mbështjellë me qefin,
dhe nisemi për në banesën ku nuk ka dhembje... dhe unë
për herë të parë u gjenda para Përjetësisë, i zgjuar, para Zotit,
me damarët blu, akull... Dhe isha unë ai që e parandalova...
një pemë molle që vazhdimisht ndryshon, shkëputet nga toka, përdridhet,
shtrin krahët – do të ikë nga këtu
me ty të marë rrugë... drejt atyre krahëve
që kanë përqaftuar
që të futura në këmishë mbahen mbi kokë
shtatë herë –
patën frikë nga lëmosha, nga ai zog i artë,
ata përhapin frikë mbi bamirësinë që vjen nga prekja jote
përhapin frikë mbi festat e së nesërmes...

... drejt krahëve që kanë përqaftuar, drejt duarve të palosur
Në namazin e përjetshëm,
Në paqen e pafundme... u nisa, për herë të fundit,
I përlur,
Poshtë shportës së madhe sa qielli –
Ku pranvera për herë të fundit e dorëzoi petkun e vet të bardhë
Si qefini yt,
Kur për herë të fundit çeli molla,
Dhoma u mbush aromë, fantazmat gjykuan jaseminin...

... drejt krahëve që përqaftuan, që me dashuri dëbuan
Detin që përmbyste, që shtypte gjoksin, që shtrydhte supet
Drejt arkivolit që notonte mbi duar e ku isha unë
Si varkë
Në detin e hapur, larg portit që nuk shihet...

KOKA I UJËMIRËVE



Lazër STANI

Pasdite erdhi prapë Koka i Ujëmirëve, baba i ushtarit të vrarë verën që shkoi. Ky dimër po më kalb trupin, doktor, më tha.

Pamja e tij e këputur, sytë e lodhur dhe të fikur, vërtetë më futën frikën. Përtej fjalëve që shqiptoi, u përpoqa të shquaj lëngatën që po e mundonte prej kohësh këtë burrë shtatlartë e të fortë si shkëmbi, që s'pati rënë kurrë në duar doktorësh. Aq më pak në duar mjekësh fshati, që më shumë sëmurin se shërojnë me këshillat dhe barnat e tyre.

Kam parë dhe ëndrra të këqija, doktor. Më mbytnë ëndrrat e këqija, tha.

Unë i bëra shënjë të ulej në shtratin e vizitave, të mbuluar me një çarçaf të bardhë, por ai nuk pranoi.

Prit njëherë, tha, të bisedojmë si burri me burrin.

Mbeta pak i befasuar nga besimi i tij tek unë, një mjek i ri fshati, djalë njëzet e gjashtë vjeçar, i diplomuar para një viti. E dija se në fshat, si gjithkund tjetër, nuk u zihej besë mjekëve të rinj si puna ime. Një mjek duhet ta ketë kokën me thinja, të mbajë me doemos syze me xham të trashë dhe të jetë pak i kërrusur nga studimi i gjatë i librave. Ç'mjek mund të jetë një djalosh, pa një thinjë në kokë e pa një rrudhë në fytyrë?!

Koka ia nguli sytë një libri të trashë që kisha lënë hapur në tryezë, pastaj këqyri rrotull, ndali sytë te librat e sistemuar në raft, tek aparatet e çuditshme mjekësore, të shpërndara andej-këtej.

Nuk di a mund të më shëndoshësh doktor, a ta lë veten në dorë të Zotit,

tha pastaj me mendjen tjetërkund.

Ngriti kokën e madhe dhe më vështroi në sy. Ngjante i merakosur, i trembur, pothuajse i pashpresë. Grushtet i mbante të shtrënguar, sikur ndrynte diçka të çmuar brenda tyre. E ftova prapë të shtrihej në shtrat dhe ta vizitoja.

Prit njëherë, tha, të tregoj se ç'po heq gjatë këtyre ditëve. Se çka është nuk e di, po gishtat me hahen me duart, duart më hahen me krahët, krahët me shpatullat, shpatullat me trupin, qafa me kryet, kërcinjë me gjunjë, kofshët me njëra-tjetrën dhe fundin e shtatit, sikur eshtrat e trupit tim duan të shqeyjnë shoqi-shoqin. A ke lexue kund për këtë sëmundje doktor?

I thashë se kam lexuar gjërë e gjatë për këtë lëngatë dhe se gjithçka do të kalojë. E di se dyshoi në fjalët e mia.

Çka të jetë e shkrueme, tha.

Ktheu kryet dhe këqyri shtratin e vizitave të mbuluar me çarçaf të bardhë.

A duhet të shtrihem?

Po. Hiq xhakëtën dhe shtrihu, i thashë.

Pasi u shtri, unë i mata pulsin, tensionin e gjakut, i kontrollova rrahjet e zemrës, i përgjova frymëmarrjen. Gjithçka normale. Pastaj i kontrollova artikulationet, gjymtyrët, mukozën e gojës dhe të bardhën e syve. Asnjë shënjë sëmundjeje.

Kokë, i thashë, nuk më tregove çfarë ëndrrash sheh.

Ngriti kryet e më këqyri i habitur, por nuk më ktheu përgjigje.

Mora bllokun e recetave të shkruara një qetësues, kur Koka ma priti:

Ah doktor, një ëndërr të poshtër,

ç'burnuese! Gjithmonë e njëjta ëndërr e ligësht, tha.

Nuk këmbëngula, i zgjata recetën ku kisha shënuar me shkronja të qarta emrin e qetësuesit të dhimbjeve dhe i thashë:

Pi nga një kokërr para se të flesh dhe kockat e tua nuk do ta kafshojnë njëra-tjetrën.

E mori recetën, e këqyri me vëmendje, e palosi katërsh dhe e vendosi gjithë kujdes në xhepin anësor të xhakëtës, e tha nëpër dhëmbë një faleminderës të zbrazët. U mat të dilte, por u ndal sikur të ishte kujtuar për diçka të rëndësishme:

Mos ma merr për të keq, doktor. Në fshatrat tona të gjithë janë të sëmurë, kujt i lëngon shtati e ma të shumtëve na lëngon mendja.

Po për mendjen e njerit s'paska doktor, tha pikëllueshëm, duke ngritur sytë nga tavani, sikur atje lart të gjendej zgjidhja.

U ngrita dhe unë dhe e përcolla deri tek porta e jashtme e Qendrës Shëndetësore. Kur u largua disa hapa, ktheu kokën e tha, pa e ndalur ecjen:

Ku të solli Zoti në këtë fshat të marrësh.

Fjalët e tij ishin të trishtuara, ngjnin me një kujë për fatin tim.

Kur u ktheva në dhomën time një copëherë nuk më hiqej nga mendja Koka, fytyra e tij e stërmadhe me kocka të dala, vetullat e tij të trasha, që tkurreshin vazhdimisht të inatosura me atë çka i shihnin sytë e i dëgjonin veshët. E dija se pas vdekjes së të birit, asgjë në këtë botë nuk ia ngrohte zemrën dhe se shpirti i tij nuk do të ngushëllohej kurrë. i biri qe

vrarë në gjumë, së bashku me disa ushtarë të tjerë nga një skuadër komandosh të huaj. Kjo e ligështonte edhe më shumë Kokën. Në gjumë, sipas tij, vriteshin vetëm qyqarët. Kështu i pati thënë ditën e varrimit të të birit, gjeneralit të ardhur nga kryeqyteti, kur i shpjegoi se si kishte ndodhur fatkeqësia.

Ptuh, i pati pështyrë gjeneralit duke shfryrë gjithë pezmin e tij: Ushtri orëpremesh.

I ktheu krahët gjeneralit me një përbuzje poshtëruese. Gjindja u përpoqën ta shfaqësonin në sy të gjeneralit, i thanë se dhembja për të birin i kishte këputur shpirtin e trullësuar mendjen.

Gjenerali nuk priti t'i dëgjonte se çfarë po thoshin. U ktheu shpinën dhe u largua kokëulur, pa u përshëndetur me njeri, i ndjekur nga pas prej dy oficerëve të rinj, që e shoqëronin. Atëherë njerëzit patën shpërthyer në të shara dhe mallkime për gjeneralët dhe ushtrinë që i vriteshin ushtarët në gjumë.

Pas humbjes së të birit, Koka rrallë dilte në qendër të Komunës. Në tavernën e fshatit, aty ku burrat mbledheshin mbrëmjeve e kthenin ndonjë gotë që të mbytnin trishtimin dhe dhembjet e jetës, Koka nuk shkeli më kurrë. Thuhej se, ditën që varrosi të birin, i paskësh thënë të shoqes:

Nuk dua të vdes në gjumë. Dua të jem esëll kur të nisem për andej.

Këto fjalë të hidhura, që ia patën ndarë në dysh zemrën të shoqes, korentoheshin mbrëmjeve në tavernë. Dhe, kur unë i dëgjova për herë të parë këtë mbrëmje, e kuptova se i kisha dhënë Kokës së Ujëmirëve ilaçin e gabuar.

E KALUARA - PASQYRË E SË TASHMES

Çdo gjë fillon me pjesën e parë nga titulli i librit, përkatësisht me vitin 1981, kohën kur krijohet kujtesa e autorit, njëkohësisht koha e krijimit të identitetit të tij. Por çfarë paraqet ky vit saktësisht për Agron Shalën?



Arsim HAMITI

Libri i Agron Shalës "1981 - vidhe këtë libër" është një libër publicistik me premisa eseistike - historike, të cilit nuk i mungon pjesa artistike për asnjë moment. Është një libër që na flet për të kaluarën e afërt dhe atë pak më të largët të vendit dhe popullit tonë, na flet për historinë që jetuam dhe atë që nuk e pamë, dhe për më shumë, na flet për identitetin kombëtar dhe krijimin e personalitetit dhe karakterit të individit nën diktaturën e një pushteti totalitar. Në të vërtetë është e vështirë të përmblihet gjithçka që gjendet, apo përshkruhet në këtë libër, thjesht me një cilësim me pak fjalë. Pra, le të fillojmë me radhë. Çdo gjë fillon me pjesën e parë nga titulli i librit, përkatësisht me vitin 1981, kohën kur krijohet kujtesa e autorit, njëkohësisht koha e krijimit të identitetit të tij. Por çfarë paraqet ky vit saktësisht për Agron Shalën? Në njërin anë është ajo çfarë paraqet ky vit për të gjithë ne që e jetuam, ajo çfarë ne mbajmë mend, apo ajo çfarë lexuam për këtë vit, që determinoi shumë ngjarje të mëvonshme për pjesën e kombit tonë këndej kufirit. Por nëse mendojmë se i dimë të gjitha për këtë vit, apo për tërë epokën sa Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë, atëherë leximi i këtij libri na thotë se gabojmë rëndë.

Ky libër, nëpërmjet shumë faktëve të dokumentuara, referencave dhe statistikave të kohës, na rrëfen një anë tjetër të shtypjes që pësoi populli ynë gjatë sistemit socialist në Jugosllavi. Na rrëfen pra, për pjesën që se pamë kurrë, për tjetërsimin e njeriut nën presionin e pamatshëm të një pushteti që qeverisë me ideologjinë utopike dhe me dhunën sistematike. Na flet për një kohë kur shqiptari i Kosovës zhvillohet në aspektin intelektual, por zhvlerësohet në aspektin kombëtar, na flet për absurdin dhe paradok-

set që lindin dhe zhvillohen në një shoqëri që e ka humbur konceptin e zhvillimit si e tërë, edhe për shkak të ndarjes nga trugu i saj natyror, por edhe për shkak të ambicieve ideologjike të rrejtshme për të krijuar një identitet të ri, që më së miri shpjegohet me idenë e pushtetit të proletariatit. Por idetë nuk realizohen lehtë në praktikë. Apo ndoshta dikush atje lart dëshiron që mos t'i realizojë fare si të tilla. Këtu lindin kontradiktat që krijojnë disa nga absurdet që përmendëm pak më lart dhe që e lënë të hutuar Agronin e vogël, në shumë nga pjesët me nota autobiografike të këtij libri. Ai fëmija i vogël i vitit 81, nuk e ka të qartë pse e mira dhe e keqja nuk janë njëjtë si në shkollë e si në shtëpi, ai nuk e di pse mes dy popujve të barabartë, njëri është pak më i barabartë se tjetri, tamam si në veprën e Orwellit, dhe për më tepër ai nuk e kupton pse frika është pjesë e jetës në çdo moment. Dhe ai si çdo fëmijë, e i rritur i asaj kohe, duhet të mësohet me të vërtetë e me vlera duale të këtij sistemi shoqëror, që natyrshëm pra, për disa është sistem ideal e për disa të tjerë sistem armik.

Në vazhdim, në kërkim të arsyeve që sjellin këtë gjendje, autori na bën një shëtitje nëpër historinë e popullit shqiptar nën sundimin osman, veçanërisht me dy shekujt e fundit të kësaj epoke, në kohën kur fillon të krijohet identiteti kombëtar, me sakrificën dhe punën e madhe të Rilindësve dhe romantikëve tanë. Por edhe këtu gjejmë të njëjtat paradokse, që tashmë janë krijuar kryesisht nga botëkuptimet fetare dhe padituria, nga interesat mesquine të njerëzve dhe nga ndërhyrjet e fqinjëve dhe superfuqive të mëdha. Shqiptarët në këtë kohë janë gjithçka tjetër, përveçse unik, të organizuar dhe me një identitet. Shqiptaria është gjithçka tjetër, përveçse një vend normal. Po, a është kjo arsyeja pse probleme të njëjta apo të ngjashme vazhdojnë të na

ndjekin edhe në realitetin e Jugosllavisë socialiste, përkatësisht në vitet e tetëdhjeta kur bota po ecte me një ritëm të shpejtë përpara? Pyetje të tilla, që dalin nga çështjet dhe temat që shtjellon ky libër, na japin një dimension të ri të realitetit të përjetuar dhe atij që e kemi mësuar nga historia e fundit e vendit dhe kombit tonë. Dhe ky realitet ngjanë i njëjtë vetëm nga emërtimi dhe jo nga përjetimi ynë i asaj epoke nga secili prej nesh, ngase siç thotë Tolstoi "Të gjitha familjet e lumtura i ngjajnë njëra-tjetrës, ndërsa secila familje e palumtur është e pakënaqur në mënyrën e vet." Dhe palumturia individuale shpërfaqet si një ndjenjë kolektive në çdo faqe të këtij libri, kur flet për kohën kur ne gjenerata e autorit u formuam në kuptimin intelektual, për kohën kur vetëdija jonë filloi të funksionojë dhe për kohën kur ne kuptuam (apo kur menduam se kuptuam) se si qëndrojnë gjërat në hapësirën dhe realitetin tonë social e gjeografik.

Por a janë të gjitha këto që përmendëm më lart, gjithçka për çfarë flet libri. Jo plotësisht. Mjeshëria krijuese dhe erudicioni mahnitës i autorit, nuk mjaftohet vetëm me kaq. Gjatë leximit të këtij libri, i cili të habitë me qindra informacionet e faktuara me anë të shumë referencave brenda tij, neve na përftohet ideja e dhjetëra, apo qindra pikëpyetjeve, që na duket se shëtisin mes rreshtash. Pikëpyetjeve, të cilave mundohemi tu japim përgjigje aty për aty, dhe të cilat domosdo i japin kuptim të veçantë leximit të këtij libri nga secili lexues, për ta bërë këtë një libër që patjetër duhet lexuar nga secili prej nesh. Gjithashtu, ajo që është më e bukura, kur sapo duket se po lodhesh me informacione dhe fakte të bollshme historike rreth sistemit, ngjarjeve kryesore, apo emrave të njerëzve, që në një apo mënyrë tjetër shënjuan këto ngjarje dhe epokat e ndryshme, atëherë na del në pah një dimen-

sion i ri artistik, pak i lëruar në librat e kësaj natyre tek ne. Është fjala për një koncept kulturor - artistik të veçantë, përkatësisht për muzikën, që në një mënyrë të padiktueshme endet nëpër rreshtat e këtij libri. Autorit duket se nuk i mjafton një përshkrim i thjeshtë i kësaj pjese të historisë së fundit të vendit tonë, që strumbullar e ka vitin 1981, vit që një farë mënyre determinoi ndarjen nga krijesa e sajuar Jugosllave. Një përshkrim i tillë do ishte paksa i thatë pa muzikë, derisa këtë koncept tematik, ai e plotëson kryesisht me rokun, i cili në këtë epokë paraqet përveç tjerash një revoltë rinore të kohës, ndërsa për librin një ngjyrim dhe çlodhje e bukur që argëton dhe informon në të njëjtën kohë.

Edhe pse libri përshkruan me një intensitet tronditës shumë dimensione të së kaluarës sonë, përkatësisht epokës socialiste dhe asaj osmane të vendit dhe popullit tonë, duke na dhënë informacione dhe njohuri shpesh të panjohura për ne, unë mendoj se ai nuk flet saktësisht për këtë kohë, apo për këto epoka historike. Të jem pak më i qartë, ai nuk flet vetëm për të kaluarën tonë. Më tepër se kaq, duke shpërfaqur problemet qenësore të së kaluarës, ndasitë, konceptet dhe ideologjitë e ndryshme që ndikuan që populli ynë të nënshtruhej një kalvari të gjatë problemesh kolektive, vuajtjesh e luftërash, ky libër, po të lexohet me kujdes mes rreshtash, na flet për realitetin që po e jetojmë tash. Ai flet për absurdin e tashmë, i cili si një pasojë e historisë së pamësuar po na përsëritet sot. Për problemet nga e kaluara që vazhdojnë të maskohen dhe na vijnë si pengesë e zhvillimit dhe prosperimit tonë kombëtar dhe shoqëror. Thjesht, na flet për ne, se çfarë jemi dhe ku jemi sot, dhe për pyetjen e fundit që të shkon në mendje sapo përfundon së lexuari këtë libër jashtëzakonisht mahnitës -pse ne jemi të tillë, siç jemi sot.

DUKE LEXUAR 13 TREGIMET E ARBËR AHMETAJ


Ato janë 69 gra nga kohë e vende të ndryshme, e megjithatë portreti i tyre mbetet i pandryshuar, krejt bio, në sytë e autorit. Portretin e tyre e skalit vet jeta

Alma ZENELLARI

Duket sikur vetëm "69 gra" dalin befaz prej fletëve të këtij libri me të njëjtin titull. E secila prej tyre është një rondo poetike më vete. Të heshtura, delikate. Të zhurmshme, rebele, të prushta. Të njohura, të panjohura. Ato janë 69 gra nga kohë e vende të ndryshme, e megjithatë portreti i tyre mbetet i pandryshuar, krejt bio, në sytë e autorit. Portretin e tyre e skalit vet jeta. Të bukura, të sarta, të hidhura ashtu si jeta e tyre e sertë dhe e hidhur. Gra të forta me kurme të lidhur, me brymë në tëmtha dhe sy misteriozë. Gra që mbushin jetën me oksigjen dhe kanë gjithë ngjyrat e lirisë në shpirt. Nga trupat e tyre dalin fluturat dhe nisen drejt luleve në oborr. Secila është një sonatë e bukur dhe të tëra së bashku një simfoni e përkryer.

Dalin nga fletët e këtij libri si liqene të dallgëzuara, duke pushuar galaksinë e ndjeshmërive, duke trazuar koshtien. Duke na lënë pa materie, veç frymë. Portrete grash të pikturuara me ndjeshmëri të pazakontë burri. Ato janë zëra të veçantë ashtu sikurse të gjitha përcjellin një histori a dramë të veçantë. Secila prej tyre përbën një kurth, mister, magji. Disa janë të buta diellore, disa janë të përvuajtura, të ashpra, inatçore. Disa janë veçse dhimbje e stamposur në kujtesën kolektive. E megjithatë gjithçka prej tyre është në lëvizje.

Arbër Ahmetaj, ky prozator me inde e vena poetike, i thërret ato në emër. I fton në një dialog të thellë shpirtëror e secila prej tyre shfaqet kush e dëlirë, naive, e sinqertë. Kush e ashpër, marroke, e guximshme, duke mbajtur brenda vetes pyllin, detin, lumenjtë, retë. Zbresin dhe ecin në një tokë të përvëlur dhe si shirat e mbrëmjeve sjellin gjithmonë një tjetër melodi të ëmbël, therëse, të trazuar. Çdo gjë e tyre, çdo gjë përreth tyre përbën një terren të pashkelur, të paeksploruar plotësisht. Është një mister që rrëqeth. Por, Arbër Ahmetaj vetëm guxon ta prek këtë terren dhe ta bëj të njohur. Ai nuk merr përsipër të bëj moral me heroinat e tij. Nuk korrigjon dhe nuk shkon kurrë drejt pyetjes "pse". Çdo grua ka rrëfimin e vet, ka potencialin e



vet. Ato jetojnë mes pasionit dhe dashurisë madje i lejojnë vetes ndonjëherë ta çojnë dëshirën e vet të çmendur deri në fund.

Në këto tregime frymojnë jetë të thjeshta njerëzore. Ato ushqejnë fantazinë (e përmbajtur) të shkrimtarit. Zhaklinë D, hap portën e këtij narracioni fantastik, që Arbër Ahmetaj e prezanton me shumë modesti pa zhurmë. Ndoshta e vendosur me kast nga autori, një Zhaklinë e cila tenton të dalë nga pusi i vetmisë dhe harresës, të kapërcejë nga hija në dritë. Ajo duket sikur i thërret gjithë të tjerat dhe i shtyn të shfaqen drejt asaj skene ku sipari tashmë është ngritur.

Sylvie, Geralda, Sophi, Fatmira, Eni gra të ëndërrta, gra poezi.

Teuta mbretëresha ilire me varrin nën ujërat e Drinit, Delacroix që ecën mbi të vdekur, Onmbele gruaja bujare, bio rrëqethëse, e Afrikës. Rozafa që del nga guri me trupin e shtypur nga vetëfljimi, për t'u ulur buzë ujërave, pranë shelgjeve në lagjen e ciganëve. Bedrija e bukur si hana mbi kullosat alpine. Gjyshja me flokët e thinjura në ajër, si re e vogël e harruar mbi supe. Ruka me shtëpinë buzë lumit, pranë shelgjeve lotues. Karen, Suzi, Sosja dhe Zadjë - nana që shpirti i gufon prej një lumturie ta pashfaqur veç në fjalë "nana të ka ty."

69 gra. Jo! Ato janë më tepër se aq. 70, 71, 171 e plot të tjera. Jam edhe unë një prej tyre që frymojnë në mitrën e secilës prej atyre

grave të vogla-të mëdha, të përzgjedhura ndoshta jo në mënyrë rastësore në këto 13 tregime. Çdonjëra ka shkarkuar energjinë e vet, pasthirrat e shpirtit, i ka lejuar vetes të tregojë dromca jete të eklipsuara. Nuk janë heroina të njohura në historinë e letërsisë shqipe, përkundrazi gjithë jeta e tyre: e shkuara, e tashmja, është mpleksur pakuptuar me heroiken. Jetë të parrëfyera, ngjarje të vogla me heroina të vogla, por që thellë - thellë ato përbëjnë shumësinë e jetëve tona, sepse zbulojnë atë pjesë të realitetit, që shumë prej nesh nuk arrijnë ta njohin si duhet me tërë vërtetësinë therëse. Duket sikur janë përzgjedhur me kast, për të hequr sadopak pluhurin e rëndë të harresës tragjike. Nuk janë mbase tërësisht protagoniste erotike, megjithatë me atipizmin e tyre, ato mbeten thellësisht mbresëlënëse.

"69 gra" as tregime, as novela, aq më pak romane, thotë modestisht autori. E megjithatë ai mbetet një libër me proza mjaft cilësore, të bukura, ndjellëse që shoqërohen nga një humor po aq fin që nuk të ndahet deri në fund të leximit. Në këtë "gërmadhë letrare", të Arbër Ahmetaj, çdo personazh ka lënë fragmente të jetës së vet, me shumë pak fjalë. Por, në ato fragmente secili prej nesh sheh vetveten me sy të kthjellët pa lente.

Dhe pse unë u ndala në dromcat jetësore të 69 grave, përsëri them bindshëm se të 13 tregimet e Arbër Ahmetaj, vijjnë kaq bukur te lexuesi, falë gjuhës tejet të pasur poetike, të pasur në stilistikë. Të mbështjella me një bukuri metaforash që të lë pa frymë. Kjo, sepse libri është shkruar nga një shpirt i sinqertë, i cili ka dëshirë jo vetëm të na rrëmbejë me rrëfimin e tij në kohëra të papërfytyrueshme dhe tronditëse, por të bëhemi njësh edhe me personazhet, me vendet apo stinët e çdo gruaje. Një libër që të pajis me dëshirën marroke, që çdo gjë të shkruar brenda atyre fletëve, t'ia tregosh me pasion çdo lexuesi që kërkon një libër cilësor në raftet e bibliotekave. Nga 13 tregime (!), unë veçova njërin prej tyre për t'i dhënë mundësinë lexuesit të përzgjedh dhe të komentojë një tjetër shkrim të këtij libri.

DËSHMI QË QARTËSOJNË KAPITUJ HISTORIE

(Mbi librin "Herë djall, herë engjell", nga Kostas Akrivos)

Rei HODO

Larmia e mendimeve mbi historinë është holistike, por ndoshta edhe për një koherencë logjike, do të mbetemi tek mendimi helen. Thënë ndryshe, ky i fundit e shikonte historinë jo thjeshtë si shkencë por si një agregat perceptimesh. Kësisoj, mendimi helen peshon më së shumti tek dëshmia historike që rrjedh nga dëshmia dhe dëshmitarët okularë. Edhe metoda historike konsiston në zgjedhjen e më pas analizimin e këtyre dëshmimeve historike.

Në thelb të kësaj analize qëndron pikërisht libri "Herë djall, herë engjell" nga Kostas Akrivos, shkrimtar e studiues grek i historisë e filologjisë. Çështje të tilla si zhvillimet e viteve 1820, roli i arvanitasve në atë që njihet si Revolucioni anti-osman i 1821, masakra e Tripolicës apo edhe vrasja e Marko Boçarit janë disa nga diskutimet që përshkruhen hollësisht në vepër. Po ashtu, duhet pasur parasysh se autori kujdeset të japë, si pikëpamje pozitive, njohjen historike jo vetëm si pranim pasiv të dëshmimeve, por edhe si interpretim kritik i tyre.

Edhe sa më sipër, të gjitha ndodhitë kanë ose gjejnë një emërues të përbashkët, Jorgos Karaiskakis për të cilin më gjerësisht do të gjendet informacion në vijim të kësaj analize.

Së pari, sikurse u përmend, janë të shumta ndodhitë historike që përshkruhen, por le të mbetemi tek njëra prej tyre, Masakra e Tripolicës. Përgjatë periudhës së rrethimit, më saktësisht nga prilli e deri në shtator të 1821, Tripolica ishte kryeqendra e Vilajetit të Moresë duke u banuar njëkohësisht nga shqiptarë, hebrenj dhe turq. Bie në sy, fenomeni i tradhtisë, të cilin e pasqyrojmë duke cituar nga libri: "Sigurisht, nuk e prisnin që Elmaz tradhtari ta fuste armikun në qytet dhe u befasuan nga sulmi i tridhjetë mijë trupave, duke mos mundur të mbrohen." Ndërkaq, lidhur me pasojat e kësaj masakre, gjejmë të dhëna të sakta në dëshminë e Jusuf Bej Moravit, sipas të cilit:



"Pjesa tjetër e banorëve, mbi dyzet mijë burra e gra, sapo dolën nga shtëpitë dhe kullat e tyre, me premtimin e prijësve të të pafeve se nuk do të pësonin gjë, ranë në duart e armiqve dhe menjëherë u kaluan në tehun e shpatës." Po në rrëfimin e këtij të fundit, gjejmë një fakt historik si vijon: "Kështu mileti i Rumeiotëve shfreu neverinë dhe urrejtjen që kishte pasur përbrenda, për katërqind vjet, e si pasojë nuk ka mbetur asnjë banor turk në Tripolicë." Nga kujtimet e Fotios Krisanthopoulos vërejmë edhe një tjetër qasje ndaj atyre që janë bërë kundërshti prej kohësh në marrëdhëniet ndërshtetërore. Rrjedhimisht, si vijon: "Pra, grekët nuk i vranë turqit nga mizoria, siç na fajësoi Europa e qytetëruar, as për ndonjë qëllim tjetër, siç e pamë,

por për hakmarrje të drejtë, të cilën e ushqenin kundër pushtuesit. Turqit e mirë ata i trajtuan si duhet, i shoqëruan, i shpëtuan dhe i dërguan ku kërkuan."

Së dyti, në vepër dalin fakte interesante lidhur me historinë e fundit të Marko Boçarit. Marrëdhëniet e tij me heroin kryesor apo edhe me të tretë gjatë periudhës historike kur gjendet në shkëlqimin e tij tregojnë shumë për të. Padyshim ajo që përflitet gjatë ka të bëjë me fundin e tij. Lidhur me këtë, nga vepra mund të citojmë: "Pas betejës në Sovolako, u ngjitëm dhe zumë Leoditon, se na ishin vënë pas ushtritë e Mustafa Pashë Bushatliut të Shkodrës. [...] Përpara se të ndodhnin këto, pashai ia doli të bëjë të keqen e madhe, vrau në Karpenisi trimin Marko

Boçari.

Për të vijuar më tej, sikurse u përmend edhe në krye të artikullit, në libër, një vend të gjerë zë edhe figura e Karaiskakit. Më poshtë, një tablo nga bashkëbisedimi i tij me Aliun, Pashain e Janinës: "- Çfarë të bëj me ty, Karaisko? Dhe Karaiskos, duke mbledhur gjithë guximin e tij, i përgjigjet: - Nëse më gjykon të denjë për zotëri, më bëj zotëri. Nëse më gjykon të denjë për hyzmeqar, bërnë hyzmeqar. Nëse nuk më gjykon të denjë as për njërin as për tjetrën, më hidh në liqen. Për ta hedhur në liqen as që bëhej fjalë. Dhe sigurisht që nuk e bëri as zotëri dhe as hyzmeqar. E bëri xhohandar, një nga të besuarit e gardës së tij personale. Si e sjell jeta... "

Për disa ishte engjell mbrojtës, për disa të tjerë hero, për të tjerë tradhtar i urryer, për të tjerë që e përdoqën armik. I adhuroar, i urryer por me fatin e pas jetës të njëjtë me atë të jetës që jetoi.

Përpos sa më sipër, në libër gjejmë përshkrime interesante edhe sa i takon Ali Pashë Tepelenës, sarajeve të tij dhe Shqipërisë së atyre viteve. "Pashë pallatet e tij të mëdha dhe të nipërve të tij, të mbingarkuar me mëndafsh e ar. [...] Por ata që binin më shumë në sy ishin shqiptarët. Mbanin fustanella të gjata, të bardha, xhamadanë të qëndisur me ar, jelekë të kuq prej kadifeje dhe kishin gjeshur në brez pistoleta dhe thika të veshura me argjend."

Në përfundim, mund të themi se libri "Herë djall, herë engjell", që vjen para lexuesit përkthyer nga Gjergji Naçi, e botuar nga Shtëpia Botuese "Jozef" shërben më së miri si një dokument bazë kuptimor mbi historinë jo vetëm të një njeriu, hero për popullin fqinj, por edhe të të gjitha makinacioneve që kanë ndodhur përgjatë historisë. Për këtë libër, do të shkonte më së miri thënia e poetit amerikan Whitman, sipas të cilit: "Duke gjykuar pjesët kryesore të historisë së botës, deri më tani, drejtësia është gjithmonë në rrezik." Mbetet të lexohet ky libër e secili të marrë atë çka është në interesin e tij.

SKEPTICIZMI MBI BOVARIZMIN POSTMODERN!

Rruga nëpër të cilën udhëtoi Floberi, na krijon edhe sot vizion jo të qartë mbi dëshirat e Emës



Emine BORIÇI

Bovarizmi është cilësuar si një rrymë e mendimit, për të cilën individ do të shkëpusë monotoninë e jetës për t'u rehatuar në mondanizmin frëng, duke shijuar risitë e aventurat e segmentuara mbi perceptimet psikiko-fizike, e siç e ashtuquan Frojdi, "bota ndiesore mbi të panjohurën", sikundër Ema Bovari, personazh protagonist që kapërcen realizmin provincial, duke kërkuar isistueshëm idealen, të panjohurën duke mos u ndalur mbi arsyen, por vijueshmëria e sentimentalizmit anoi katërçipërisht mbi logjikën e shqipëruar, më saktë në dy dikotomi bashkëshort-fëmijë, Leon- Rudolf, të cilët natyrshëm kthehen në vorbull ngjarjesh duke prevaluar figurën femërore të Emës.

Kompleksiteti që karakterizon figurën, karakterin e sjelljet e saj, mund të përqasen me

heroinat e lexuara në romanet e në një farë forme mund ta përkufizojmë si protagonist me karakter të dyfishtë, e zor se mund të ndajmë Emën nga personazhet e librave, sepse vetë narratori na dëshmon që Ema, një vajzë e zgjuar dhe e edukuar me botën shumëngjyrëshe të librave rrëmon detajet të Sharlit që nuk e përplotësojnë, por turpshëm arrin t'i zhbirojë ato në të tjerë individë e realiteti i gënjeshtërt, me Rudolfin solli atë "plotësi" perfekte, aspiratë kjo duke shkaktuar bjerje të psikologjisë së vetvetes, Sharlit, vajzës apo të personazheve të tjerë ku në fakt Floberi nuk i dënon, madje mendohet se ai ka ndjekur metodën e impersonalizmit, duke mos i gjykuar apo duke mos mbajtur një qëndrim mbi favorizimin e njërit apo tjetrit personazh brenda Botës së Trilluar. Në gjyqin e Njëmendësisë, ai per-

sonifikon vetveten si Bovaria veshur nën mantelin e fajësisë së saj. Rruga nëpër të cilën udhëtoi Floberi, na krijon edhe sot vizion jo të qartë mbi dëshirat e Emës. Ajo parapëlqeu duart e bukura të Charlit, por jo atë. Në këto hapa vijon me Leonin dhe Rudolfin derisa shpëton nga kjo botë duke udhëtuar drejt amshimit. Por, a la gjurmë të pashlyeshme në letërsi?

Letërsia është një koncept i thukët aparenial, por brendia befason me larushinë e personazheve, kohës, hapësirës, llojet e rrëfyësve, lojës romaneske e çdo teknikë tjetër e pathënë. Ema Bovari nuk zbehet edhe në vepra tjera. Ajo universalizohet në romane të rrymave të tjera, mbase e pikë-parë edhe në periudha antike deri në postmodernizëm. E mirë, e urtë e deri në avangardimin e egërsisë së periudhës së tanishme.

Postmodernizmi zhvesh parimisht figurën femërore, duke e paraqitur atë të pambrojtur dhe përkrahja e vetme është mbështetja te forcat e veta, ku kjo femër shfaq hijeshinë femërore e jo vetëm. Nëse i referohemi disa personazheve të veprave postmoderniste, janë edhe figura mashkullore të cilët gjenden të parehatshëm në grupin e rrëfimit mbi ta. Kërkojnë hapësira mirëkuptues mbi veprimet me vetveten dhe të tjerët.

Kristi i Kongolit kapërcen në tre breza për të gjetur përplotësimin e idealeve dhe zbërthimin e medaljonit, i cili bëhet katalizator largpamës mbi bukurinë femërore të Dolorës, Lizës e Lorit.

Personazhi Parashqevi e Kongolit ka një psikologji të rënduar, një ndjenjë të ndrydhur mbi aspektin dashuror, mungesa e një familjeje, e ky refleksion na tregohet kur ajo punonte në vilë. Shpesh ajo

jetëson përballjen me vetveten në pasqyrë ku njëra gjendet në banjë, e dyta në sallon dhe e treta në dhomën e gjumit, e në mënyrë indirekte i referohemi shtresave palimsesike të nëndërgjegjes së saj. Pasqyra më e madhe, ajo e sallonit e ballafaqon me personazhin që ajo do qëndrojë e kyçur ndaj të vërtetës jetësore të vetvetes në raport me të tjerët.

Martin Gega e raporti i tij ndjesor subkoshientar me Etleven që mund të ishte e kujtudo, por vetëm e tij jo. Tufa përdor teknika pegasike, duke fluturuar dhjetë vite pas në kohë për të kuptuar kontekstin ideor të veprës, e dueli shpirtëror i personazhit na paraqitet në fund romanit si peng i një fajësimi zanafillor. Nuk presim një Deux ex Machina për të shpëtuar prej një gabimi, por kuptojmë që Martini bëhet teknika e vetvetes, duke e zbuluar nëpërmjet fjalëve të plakut dhe pranimit të shiut si katarsisi shpirtëror të tij.

Ku duket bovarizmi në këto personazhe? Ne cekëm më lart se bovarizmi ishte shpëtim nga realiteti, e këta personazhe janë të prekshëm me realitetin dhe në momente sekondare reagojnë nga një stimuli të njërit apo tjetrit personazh, duke krijuar tablonë e karakterit të tyre. Personazhet si Kristi, Parashqevia dhe Martin Gega kërkojnë aventurën e paprovuar duke rehatuar shpirtin e mendjen në idealin paprekshëm, prandaj ata ushqehen me thërrimet e bovarizmit floberian.

Secili nga personazhet është paksa Ema Bovari nga karakteri, nga dëshirat apo nga synimet mbi jetën, madje kjo Emë po ndihet si parfum edhe në Botën e Njëmendësisë, që mbase po shkakton tragjedi apo kënaqësi momentale te bota mashkullore.

HERMETIZMI INSTIKTIV

Ndoshta i vetmi vend ku mund të gjendet Artur Rimbaud, është vetëm në poezitë e tij, por ai as aty nuk arriti ta gjente vetveten



(Hamdi) Erjon MUÇA

Stephan Mallarme ishte dhe mbetet babai natyral i hermetizmit, i drejt-përdrejtë, pa dritëhije, pa mëdyshje, ndërsa Rimbaud, ndonëse hermetist, është një paradoks më vete. Mund të konsiderohet si sofisti i fundi i njerëzimit, por edhe në këtë konsideratë nuk i largohet paradoksit. Në shumë aspekte i ngjet dervishëve të sektit të humbur, Kalendarit; poetë, filozofë, nomadë, lëmshëkërkuar dhe që shumë herë janë akuzuar për pederasti. Për shumë aspekte, ndonëse nuk kemi fakte nëse Rimbaud kishte njohuri mbi zakonte e këtyre dervishëve, i ngjet pikërisht këtyre; Dëshira e madhe që kishte për t'u endur, për të gjetur një vend ku të ndihej mirë, endjet me poetin tjetër Verlaine, deri në çastin kur ky i fundit e plagos me pistoletë dhe burgoset.

Një shpjegim të mrekullueshëm të këtij personazhi, kësaj dukurie njerëzore, na e jep një studim i profesor Alessandro Quattrone, një nga përkthyesit dhe, në mos, njohësi më i mirë i Rimbaud-it në Itali. Quattrone mundohet të na e paraqesë Rimbaud-in nën këndvështrimin njerëzor, të djaloshtit të brishtë psikologjikisht, të poetit që me ardhjen e tij ndryshoi rrënjësisht kontekstin poezi, dhe të krijesës që kapitulloi nën trysinë e dy forcave në përplasje, krejtësisht të kundërta por intensivisht të barasvlershme; bymimi i ndjesive krijuese dhe trysnia e efimeritetit real njerëzor. Ndërsa unë do të mundohem t'ia zhbij nga një tjetër këndvështrim; intensiteti sofistifik brenda një poezie të vetëm.

Rimbaud, edhe si poet është paradoks. Ai kalon nga një naivitet, gjenial, hermetik, tek ky hermetizëm i lindur, aspak i kërkuar me forcë, si ai i Mallarme-së. Poezinë Lot ai e nis kështu:

Larg nga zogjtë, nga kopetë dhe fshatet,

pija i përkulur nuk e si se në cilën shqopishte

rrethuar nga të buta pyllishte lajthish, nën mjegullën e një të vakëte dhe të gjelbër pasdite.

Ka këtë mendim, që përbën një strofë

të plotë ndaj dhe unë nuk e ndava. Poeti, tashmë, edhe fizikisht, por edhe shpirtërisht, madje edhe psikikisht, ndihet, është larg njerëzimit dhe gjithçkaje e përfaqëson. Ashtu siç do të bënte Zarathustra shumë vite më pas, poeti ka kërkuar largimin nga qytetërimi, me shpresë për të gjetur vetveten; ose Kimerën; hipotezën absurde, ëndrrën e kotë, utopinë me emrin qenësi. I lodhur, i etur, rrethuar vetëm nga kompozime kimike të heshtura, që ashtu si njerëzit lindin dhe vdesin, duke dhënë frytet e veta në këtë segment kohor relativ, të palëvizshëm, me pamundësinë e endjeve në kërkim të ideale, ndoshta pa kokëçarjen e ankthit që shoqëron kërkimet. Pra një lloj kthimi në primitivitet për të gjetur qetësinë, vetveten e humbur ndër hallkat e evoluimit:

Çfarë mund të pija në atë rioshe Oise, vidhe të heshtur, qiell i mugët, barë pa lule.

Strofën e dytë e nis me këto dy vargje që përbëjnë një mendim disi më të sofistikuar dhe paradoksal. Duket sikur këtu mbështet tek maksima e famshme e Heraklitit: Nuk lagesh kurrë dy herë në të njëjtin lum. Duket sikur poeti ka përfutur bindjen, që përse të mundohet të primitivizohet për të gjetur atë diturinë apoteozike të shumë ëndërruar, nuk do të arrijë kurrë ta përftojë; koha është një paradoks universal, plaket duke mbetur gjithnjë e re, e rrjedhshme. Gjithçka e rrethon poetin është një heshtje, që lëviz palëvizshmërisht. Gjithësia shfaq gjithçka, por pa treguar asgjë:

Çfarë rridhte nga faqorja e kolkozit? Ndonjë

liker prej ari pa shije që të sjell edhe djersitje.

Kur thash që kjo strofë është më komplekse se sa strofa e parë, nuk kisha parasysh vetëm vargjet e para, por të gjithë strofën. Nga ajo vetëdija e përfutur prej poetit, që askund jashtë tij nuk mund të përftojë atë dijen universale, që sipas një pjese të mirë të filozofëve, kemi humbur me evoluimin, poeti ka bindjen që edhe në brendësinë e vet, ajo dije nuk mund të gjendet. Këtë e bën me sofizëm. Faqorja e kolkozit; kolkozi është një

bimë që rritet për më tepër në vende të lagështa, të ngrohta dhe me hije; është një nga ato lloje lulësh që nuk lulëzon, por ç'lulëzon. Pak a shumë si krijesa njerëzore, që nuk matoron, por plaket. Dhe çfarë mund të përfitosh në zhbirim-in e kësaj brendësie që vetëm sa degradon kimikisht, përpos të ndonjë mendim, teorie, apo edhe metafore xixëlluese, që vetëm sa të shton angësh-timin e mosgjetjes së një përgjigje; përvijimin e një rrethi, ku pyetjeve, nuk mund t'u përgjigjesh përveç se me pyetje?!

Kështu, unë paskam qenë e shëmtu-ara tabelë hoteli.

Strofa e tretë e paraqet egërsisht të vërtetën e një kapitullimi të parashkruar. Krijesa njerëzore, kupton, herët a vonë, që nuk është as më shumë e as më pas se të gjitha krijesat e këtij ambienti që e rrethon. Si për inat të të gjithë atyre që duan të na bindin se ne jemi projekti, apo edhe pikënisja e diçkaje më të madhe, poeti, filozofi, na thotë se nuk jemi as hoteli që mendohet se duhet të bujë dijen, fatin, apo pikënisje dhe mbërritjen, jo ne nuk jemi tjetër veçse tabela treguese e bujtinës. Jemi jashtë, kemi qenë jashtë dhe do të mbetemi jashtë. Tjetër gjë është bujtësja e të vërtetës universale dhe nuk ka të bëjë me ne:

Më pas qielli ndryshoi deri në mbrëmje nga një e dhunshme

stuhi. E u dukën katunde të zinj, liqene,

shtylla, kolona nën natën blu, stacione.

Strofën e mbyll me këtë mendim të gjatë që duket sikur i rikthehet paqësisë së strofës së parë. Gjithçka që lëviz, njëtrajtëshit, gjithnjë ndryshe, në këtë botë të ndërtuar nga njerëzit, sipas shëmbëlltyrës së tyre:

Tretej mbi të virgjëra ranishte uji i pyjeve,

prej erës binin akuj mbi kënetë...

Pas asaj paqëtie të gjetur në përfundim të strofës së tretë, poeti kërkoi të thotë akoma diçka, diçka e rëndësishme i kaluar pa thënë, një e vërtetë, por që nuk përbën një përgjigje, por një pyetje perpetum, në reshtin e atyre pyetjeve që ne tashmë kemi vendosur t'i përdorim si përgjigje. Ajo dija e kondensuar univer-

sale, uji i pyjeve, humbet nëpër ranishte të virgjëra, krijesa gjithnjë të etura, të reja, paprekura, të pazota për të mbajtur diturinë njerëzore. Nga dukuritë, edhe natyrore mund të quhet, e lëvizshmërisë, binin akuj, dituri të ngrira të destinuara, ashtu akulli që bëhet ujë, të ndërhyjnë, mbi ujën e kënetës, të përzihen me të, pra diturisë së përfutur dhe të kondensuar në pikën, ndoshta të duhura, për të na dhënë përgjigje, duke e holluar sërish, duke i shtuar pyetje të reja, atyre pyetjeve që sapo kishin nisur të merrnin formën e përgjigjes përfundimtare:

Dhe të thuash që unë, njëlloj si një peshkues ari

ose grackash, nuk u shqetësova të pija! Poeti nuk mund ta mbyllte poezinë, pa na shprehur pezmin, keqardhjen, që e ka kapluar pasi ka zbuluar kapitullim e parashkruar. Ndonëse nga toni i vargjeve të fundit, duket sikur ka kohë që e ka ndjerë këtë lloj përfundimi, ndihet habia e një krijese optimiste. Sikur do të thotë: megjithëse i vërejtja të gjitha këto anakronizma që tregonin qartë se ky është një shteg i mbyllur, unë sërish, me kokëshkretësi desha ta ndërmarra.

Ja pra ky ishte paradoksi Rimbaud. Një krijesë pesimiste në optimizëm dhe optimist përkundër gjithë pesimizmit që e rrethonte. Hermetik, instinktivisht dhe naivisht. Tepër i ri si për të kalëruar fitoret po ashtu edhe për të përballuar humbjet. Kërkoj Artur Rimbaud-in kudo, por nuk e gjeti askund. As brenda vetes dhe as jashtë sajë. Ndoshta i vetmi vend ku mund të gjendet Artur Rimbaud, është vetëm në poezitë e tij, por ai as aty nuk arriti ta gjente vetveten. Ndoshta edhe aty pa një refleks të asaj që mendon se nuk i përkiste atij, por një pyetje, të maskuar si përgjigje.

LOT

Larg nga zogjtë, nga kopetë dhe fshatet,

pija i përkulur nuk e si se në cilën shqopishte

rrethuar nga të buta pyllishte lajthish,

nën mjegullën e një të vakëte dhe të gjelbër pasdite.

Çfarë mund të pija në atë rioshe Oise, vidhe të heshtur, qiell i mugët, barë pa lule.

Çfarë rridhte nga faqorja e kolkozit? Ndonjë

liker prej ari pa shije që të sjell edhe djersitje.

Kështu, unë paskam qenë e shëmtu-ara tabelë hoteli.

Më pas qielli ndryshoi deri në mbrëmje nga një e dhunshme

stuhi. E u dukën katunde të zinj, liqene,

shtylla, kolona nën natën blu, stacione.

Tretej mbi të virgjëra ranishte uji i pyjeve,

prej erës binin akuj mbi kënetë...

dhe të thuash që unë, njëlloj si një peshkues ari

ose guaskash, nuk u shqetësova të pija!

(Maj 1872)

NUMRI I ARDHSHEM ME 20 PRILL

HEJZA

10 PRILL, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtör: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000